

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

GJYKATA KOMUNALE PRISHTINË

P. No. 1960/2009

Datë 7.04.2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE PRISHTINË me trupin gjykues te përbërë nga gjyqtari EULEX-it Gianfranco Gallo si gjyqtar kryesues, gjyqtari i EULEX-it Jonathan Welford-Carroll dhe gjyqtarit vendor Faik Hoxha si anëtarë të trupit gjykues, në lëndën penale kundër

- **Sejdi Zeqirit**, lindur në 4.3.1960, në Prishtinë, vendbanimi, Rruga Nëna Terezë, Prishtinë.

akuzuar, sipas aktakuzës PP. Nr. 2967-3, të datës 2 Tetor 2009, dhe ndryshuar në seancat e gjykimit kryesor të datave 21 Tetor 2010 dhe 5 Prill 2011, për veprat penale të mëposhtme:

- a) Shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin, në shkelje të Nenit 200, pragrafi 2, pika 1 e Kodit Penal të Kosovës (KPK);
- b) Marrja e rryshfetit, në shkelje të Nenit 343 paragrafi 1 të KPK;
- c) Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit, në shkelje të Nenit 339 paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 të KPK;
- d) Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrave, në shkelje të Nenit 164, paragrafi 1 të KPK

Pas seancave të shqyrtimit kryesor të mbajtura në;
18 dhe 21 Tetor 2010;
2, 3, 4, 11, 19, 30 Nëntor 2010;
3, 6, 10, 17 Dhjetor 2010;
21 dhe 24 Janar 2011;
1 dhe 5 Prill 2011.

Pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur në 5 Prill 2010, bazuar në Nenin 389 paragrafi 1, 390 dhe 391 paragrafi 1 të KPPK,

në 7 Prill 2010, sipas Nenit 392 Paragrafi (1) të KPPK, shqipton në publik dhe në prani të akuzuarit, prokurorit të EULEX-it, si më poshtë

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Aktgjykim

Hidhet poshtë ngarkimi penal në lidhje me pikat 2, 6, dhe 8 të aktakuzës, meqenëse Prokurori i tërhoqi ngarkimet e mësipërme penale përpara përfundimit të gjyqimit kryesor.

Sejdi Zeqiri

LIROHET NGA AKUZA

për veprën penale të Shpërdorimit seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin, në shkelje të Nenit 200, paragrafi 2, pika 1 e Kodit Penal të Kosovës (KPK) në lidhje me episodin që ka të bëjë me S K (pika 4 e aktakuzës), meqenëse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën për të cilën është akuzuar;

LIROHET NGA AKUZA

Për veprën penale të Marrjes së rryshfetit, në shkelje të Nenit 343 paragrafi 1 të KPK, në lidhje me episodin që ka të bëjë me Bekim Bajramin (pika 7 e aktakuzës) meqenëse nuk është provuar që i akuzuari ka kryer veprën për të cilën është akuzuar;

GJENDET FAJTOR

Për episodin e Shpërdorimit seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin, në shkelje të Nenit 200, paragrafi 2, pika 1 e Kodit Penal të Kosovës (pika 1 e aktakuzës), sepse në 2006, në Stacionin e Policisë në Obiliq, në pozitën e tij si komandant i stacionit të policisë, duke shpërdoruar kontrollin e tij mbi punësimin e M P, oficere e policisë në stacionin e mësipërm, gjatë një takimi me të, e mbërtheu për dore M P për qëllime seksuale dhe u përpoq ta puthte atë në buzë, duke arritur ta puthë atë në faqen e djathtë;

GJENDET FAJTOR

Për veprën penale të Tentativë për Shpërdorim seksual duke keqpërdorur pozitën zyrtare, autoritetin apo profesionin në shkelje të Nenit 20 dhe 200, paragrafi 2, pika 1 të Kodit Penal të Kosovës (pika 3 e aktakuzës), që ka riklasifikuar akuzën origjinale të Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrave, në shkelje të Nenit 164 paragrafi 1 të LPK, sepse në Maj apo Qershor 2008, në Stacionin e Policisë në Obiliq, në postin e tij si Komandant i Stacionit të Policisë së Obiliqit duke abuzuar kontrollin mbi punësimin e V G, oficere e policisë në stacionin e mësipërm, gjatë një takimi me të ai ndërmori një veprim të menjëhershëm ti

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

prekte shpatullën e V G t për qëllim seksual dhe ta puthë atë, duke mos arritur të përfundojë veprimin e tij;

GJENDET FAJTOR

për veprën penale të Marrjes së Rryshfetit, Neni 343 paragrafi 1 të KPK (pika 5 e aktakuzës) sepse në Maj apo Qershor 2008, në Obiliq, në cilësinë e tij si Komandant i Stacionit të Policisë së Obiliqit, pra atë të një personi zyrtar, ai pranoi nga Bajram Zeqiri 500 Euro me qëllim që të kryejë brënda kompetencave të autoritetit të tij, një veprim zyrtar që ai nuk duhet ta kishte kryer, që ishte, ti jepte një ndihmë të përgjithshme Bajram Zeqirit me qëllim që ta bënte Bekim Krasniqin të largohej nga apartamenti që i takonte Bajram Zeqirit;

GJENDET FAJTOR

për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrave, në shkelje të Neni 164, paragrafi 1 të LPK (pika 9 e aktakuzës) që ka riklasifikuar pikën e akuzës origjinale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit, në shkelje të Neni 339 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPK, sepse nga 2006 deri në 2009, në stacionin e policisë së Obiliqit, në postin e tij si komandant i stacionit të policisë, pra atë të personit zyrtar, ai ka keqtrajtuar dhe fyer K H, oficerë e policisë në stacionin e mësipërm të policisë, duke i thënë asaj në shumë raste “ti nuk vlen fare, ti nuk di si të ecësh, je e ndyrë”;

GJENDET FAJTOR

për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrave, Neni 164 paragrafi 1 i KPK (pika 10 e aktakuzës), sepse në 21 Gusht 2009 në Stacionin e Policisë së Obiliqit, në pozitën e tij si komandant, pra, atë të një personi zyrtar, ai keqtrajtoi, frikësoi dhe fyeu K Bn duke i thënë fjalët në vijim: “E di që për sa kohë të jem unë këtu ti nuk do të guxoje të shkoje në ndonjë vend tjetër? Është e qartë se ti nuk je normal. E di që unë të paraburgos?”

PRANDAJ, i akuzuari,

DËNOHET

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Me gjashtë muaj burgim për veprën penale të Shpërdorimit seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin (pika 1 e aktakuzës) me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 3 vjet

Me katër muaj burgim për veprën penale të Tentativës së Shpërdorimit seksual nëpërmjet keqpërdorimit të pozitës zyrtare, autoritetit apo profesionit (pika 3 e aktakuzës) me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike apo shërbimin publik për 3 vjet;

Me një vit burgim për veprën penale të Marrjes së rryshfetit (pika 5 e aktakuzës) me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike apo shërbimin publik për 3 vjet;

Me gjashtë muaj burgim për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrave, (pika 9 e aktakuzës) me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve të administratës publike apo shërbimit publik për 3 vjet;

Me katër muaj burgim për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrave, (pika 10 e aktakuzës) me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve të administratës publike dhe shërbimit publik për 3 vjet;

Dënimi për bashkimin e veprave penale, sipas Nenit 71 paragrafi (1), (2) dhe nënparagrafi 3 dhe paragrafi 3, të KPK, është caktuar për 2 vjet e katër muaj burgim me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike apo shërbimin public për 3 vjet;

Koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga i pandehuri nga 27.8.2009 deri në 5.1.2010 do të llogaritet në dënimin, sipas Nenit 391 paragrafi (1) nënparagrafi 5 dhe Neni 278 paragrafi 7 i KPPK.

I akuzuari duhet të mbulojë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 102 Paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të kostove të përkthimit gojor dhe të shkresave. Kostoja e përcaktuar është 40 euro për seancë, në një shumë të përgjithshme prej 640 Euro.

ARSYETIMI

1. Historia e procedurës

Në 24 Gusht 2009 është dërguar një kallëzim penal fillestar në Zyrën e Prokurorisë Publike Komonale kundër të pandehurit Sejdi Zeqiri për kryerjen e veprave të mësipërme penale.

Në 27 Gusht 2009, i pandehuri u arrestua dhe prokurori paraqiti në Gjykatën Komonale të Prishtinës një mocion për të caktuar paraburgimin kundër tij; kërkesa nuk u aprovua

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

dhe kundër Sejdi Zeqirit u caktua masa e arrestit shtëpiak që fillon që nga data e arrestimit.

Në 3 Shtator 2009, është paraqitur përpara Gjykatës Komunale të Prishtinës një propozim-aktakuzë, aktakuzë që u ndryshua me vepra të tjera penale në 9 Shtator 2009, megjithatë në 24 Shtator 2009 gjyqtari për konfirmim ja ktheu propozim aktakuzën Prokurorit, duke konsideruar se Prokurori duhej të kryejë hetimet ashtu sic duhet dhe të paraqisë me tepër.

Në 2 Tetor 2009 prokurori paraqiti një aktakuzë ku akuzonte të pandehurin në dhjetë pika dhe në 15 Tetor 2009, gjyqtari për konfirmim Driton Muharremi me vendimin KA. 274/2009 konfirmoi aktakuzën kundër Sejdi Zeqirit.

Në 29 Tetor 2009 prokurori EULEX-it ju drejtua Zyrës së Presidentit të gjyqtarëve të EULEX-it me një kërkesë që kjo lëndë ti caktohej gjyqtarëve të EULEX-it (kërkesa u mbështet nga Kryetari i Gjykatës Komunale me letrën e datës 20 Nëntor 2009).

Në 23 Nëntor 2009, në Gjykatën Komunale të Prishtinës u mbajt një seancë nga Presidenti i gjyqtarëve të EULEX-it për të vlerësuar nëse kjo lëndë duhej të merrej nga gjyqtarët e EULEX-it dhe pas kësaj, lënda i u caktua gjyqtarëve të EULEX-it.

Gjykimi filloi në 18 Tetor 2010. Trupi gjykues fillimisht ishte i përbërë nga gjyqtari EULEX-it Jonathan Welford Carroll, gjyqtarja kosovare Elmaze Fazliu dhe gjyqtari kryesues Gianfranco Gallo. Pas formaliteteve paraprake (duke përfshirë komunikimin për përbërjen e trupit gjykues, verifikimin e fletëthirrjeve për dëshmitarët) filloi dëgjimi i dëshmitarëve dhe po atë ditë u dëgjuan M P dhe K H.

Në seancën dëgjimore të 21 Tetor 2010, prokurori ndryshoi aktakuzën si më poshtë: Akuzimet në lidhje me pikat 1 dhe 3 të aktakuzës, të klasifikuara fillimisht si Shpërdorim seksual në shkelje të Nenit 200, paragrafi 1 i KPK, u ri-klasifikuan si Shpërdorim seksual në shkelje të Nenit 200, paragrafi 2, pika 1 të KPK. Akuza që lidhet me pikën 10 të aktakuzës, fillimisht e klasifikuar si Shpërdorimi i detyrës zyrtare në shkelje të Nenit 339 të KPK, është riklasifikuar si Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në shkelje të Nenit 164, paragrafi 1 të KPK.

Në seancën e 5 Prillit 2011 prokurori publik i tërhoqi ngarkimet penale lidhur me pikën 2, 6, dhe 8 të aktakuzës ndërsa ngarkimi penal në lidhje me pikën 3 të aktakuzës u riklasifikua si Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave në shkelje të Nenit 164, paragrafi 1 të KPK.

Në seancat dëgjimore të renditura më poshtë, janë pyetur dëshmitarët dhe palët e dëmtuara të mëposhtme:

Në 21 Tetor 2010, u pyetën V G, K H dhe K B;
në 2 Nëntor 2010, u pyetën S K, Bujar Grajqevci dhe Sedat Kelmendi;
në 3 Nëntor 2010, u pyet dëshmitari Naim Buzaku;
në 4 Nëntor 2010, u pyetën dëshmitarët Fatmir Mjekiqi dhe Dritan Islami.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Në 19 Nëntor 2010, gjyqtarja Elmaze Fazliu u zëvendësua nga gjyqtari Faik Hoxha, meqenëse kjo e para kishte paraqitur një kërkesë për skualifikimin e saj dhe që ishte aprovuar nga Kryetari i Gjykatës. Gjykimi filloi nga fillimi, por me pëlqimin e palëve egzaminimet e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve të kryer deri atëhere u konsideruan si të lexuara. Vetëm pala e dëmtuar M P u pyet përsëri.

Në 30 Nëntor 2010, u pyet dëshmitarja eksperte V M;
në 3 Dhjetor 2010, u pyet dëshmitari Bekim Bajrami;
në 6 Dhjetor 2010, u pyetën dëshmitarja V M dhe dëshmitarët Naim Mulaku dhe V H;
në 10 Dhjetor 201, u pyetën dëshmitarët Sejdi Haxholli dhe Sevdije Borovci;
në 17 Dhjetor 2010, u dëgjua dëshmitari Bajram Zeqiri;
në 21 Janar 2011, u dëgjua dëshmitari Agim Krasniqi dhe u paraqit dhe u lexua lista e provave material sipas Neneve 367 dhe 371 të KPPK;
në 24 Janar 2011, u thërrit për të dëshmuar Zyra Zeqiri (gruaja e të pandehurit), por ajo shfrytëzoi të drejtën e saj për të mos u përgjigjur sipas Nenit 160 të KPPK;
në 1 Prill 2011 u pyetën dëshmitarja Fikrije Misini dhe i pandehuri;
në 5 Prill 2011 u pyet përsëri i pandehuri dhe pas fjalëve përmbyllëse, në 7 Prill 2011, u shpall aktgjykimi.

Deklaratat, raportet e policore, raportet mjeksore, provat e ekspertizës dhe shkresore

Raportet policore

- Dritan Islami raporti policor i datës 17 Prill 2009 (plani operacional Pranvera)
- Fatmir Mjekiqi raporti policor 17 Prill 2009 (plani operacional Pranvera)
- Naim Buzaku raport policor 17 Prill 2009 (plani operacional Pranvera)
- Plani operacional i operacionit “Pranvera” i datës 16.04.2009.
- Raporti i Inspektoriatit të Policisë së Kosovës ‘IPK’ mbi Sejdi Zeqirin i datës 4 Gusht 2009 për procedurën disiplinore në lidhje me operacionin “Pranvera”.
- Raport informativ për të pandehurin nga Inspektoriatit të Policisë së Kosovës
- Raporti i policisë i datës 8 Nëntor 2010 për vendodhjen e Nexhip Zeqirit.
- Raporti i policisë i datës 29 Tetor 2010 për Bekim Bajramin
- Raporti i policisë i datës 9 Nëntor 2010 për Bekim Krasniqin
- Raporti i policisë i datës 6 Tetor 2009 mbi hetimin financiar për të pandehurin
- Raporti i policisë i datës 27 Tetor 2009 mbi përmbledhjen e hetimeve financiare për të pandehurin
- Raporti i Njësisë së Hetimit Financiar të EULEX-it i datës 21 Shkurt 2011

Raportet mjeksore

- Raporti i psikiatrit Ferid Agani për M P i datës 25.08.2009
- Raporti i psikologes Sabina Dishallari për V G n i datës 02.09.2009
- Raportet mjeksore për Sejdi Zeqirin paraqitur nga avokati mbrojtës Bajram Tmava depozituar në 16 Dhjetor dhe 18 Janar 2010.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Dokumentat e dorëzuara të M P

- një bllok i vogël shënimesh që përmban shënime të shkruajtura nga pala e dëmtuar,
- raporti mjeksor i datës 21.06.2007
- certifikatë mjeksore e datës 14.11.2008,
- certifikatë mjeksore e datës 05.08.2006,
- certifikatë mjeksore e datës 13.08.2008,
- shkresë që vjen nga Ministria e Punëve të Brëndshme, e datës 18.01.2008.
- fletë e shkruajtur me shkrim dore që nuk ka datë,
- memo zyrtare e datës 29.08.2008, (dy memo me të njëjtën datë këtu, njëra është kërkesë për egzaminim mjeksor dhe tjetra, një kërkesë tjetër për ndryshimin e vendit të saj të punës) me tre certifikata mjeksore të bashkëngjitura,
- shkresë nga SHPK e datës 18.01.2007
- raporti i specialistit i datës 18.12.2009,
- raport i mëtejshëm i specialistit i datës 24.07.2008,
- dhe një deklaratë e dëshmitarit e datës 24.02.2009.

Dokumentat e dorëzuara të K B:

- Certifikatë nga spitali e datës 20.08.2009
- Certificate nga Klinika Universitare e datës 09.08.2009
- Certificate nga Klinika Universitare e datës 16.08.2008,
- Certifikatë mjeksore e datës 27.09.2001
- Certificate nga Klinika Universitare e datës 09.08.2009;
- Certificate nga Klinika Universitare e datës 11.09.2007
- Certificate nga Klinika Universitare e datës 10.08.2009
- Certifikatë mjeksore e datës 21.06.2009;
- Certifikatë mjeksore e datës 24.02.2006.
- Certifikatë mjeksore e datës 13.08.2009
- Certifikatë mjeksore e datës 13.08.2009

Raport i ekspertizës

- Raportet e grafologjisë nga laboratory forensik lidhur me shkrimin e dorës së S Kt të datave 26.11.2010 dhe 3.12.2010.
- Raport mjeksor i datës 20 Janar 2011

Deklarata e marrë pa pëlqimin e palëve sipas Nenit 368 paragrafi 1 pika 1 të KPPK

- Deklarata e Bekim Krasniqit dhënë policisë në 21 Gusht 2009.
- Deklarata e Nexhip Zeqiri, dhënë policisë në 17 Gusht 2009.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Provat e paraqitura nga mbrojtia

Vendimi i inspektoriatit të policisë së Kosovës ku shkruhet se masat disiplinore kundër Sejdi Zeqirit kishin përfunduar, paraqitur në seancën e 3 Nëntorit 2010.

Lista e historisë penale të palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, depozituar pranë trupit gjykues në seancën e datës 1 Prill 2011.

Letra përcjellëse e datës 18 Janar 2011 së bashku me raportin mjeksor dhe letrën e daljes nga Qendra e Kardiologjisë të datës 24 Dhjetor 2010.

Letra përcjellëse e datës 16 Dhjetor 2010 bashkë me raportin mjeksor të datës 16 Dhjetor 2010.

Raport mjeksor i datës 17 Janar 2011.

Një listë certifikatash vlerësimi dhe letrash rekomandimi për të pandehurin.

2. RIKONSTRUIMI FAKTIK I NGJARJEVE, VLERËSIMI I PROVAVE TË PARAQITURA DHE KUALIFIKIMET LIGJORE

Aktakuza e paraqitur nga Prokurori, dhe më pas e ndryshuar në më shumë se një rast, përbëhet nga 10 pika të aktakuzës që nuk janë të lidhura me njëra tjetrën që mund të egzaminohen veçmas njëra tjetrës, meqenëse secila pikë e aktakuzës ka një burim të ndryshëm prove.

2.1. Episodi që ka të bëjë me M P (pika 1 e aktakuzës).

Në lidhje me këtë episod, e vetmja provë paraqitur nga Prokurori ka qenë dëshmia e dhënë nga pala e dëmtuar.

Më poshtë paraqitet pjesa më relevante e dëshmisë së saj:

M P: Kjo ndodhi në Dhjetor 2004. Më është thënë – atë natë unë duhej të filloja turnin e natës në orën 23:00 - por rreth orës 19:00 Sejdi Zeqiri erdhi në shtëpinë time dhe më kërkoi që të shkoja në stacionin e policisë sepse ishte një lëndë me plagosje me armë zjarri. Mua madje më kujtohen emrat e të dyshuarve dhe viktimave në këtë lëndë.

Prokurori Publik Vendor: Kush ishin viktimat?

M P: E dyshuara quhej S nga një vend i quajtur Lum i madh. Viktima quhej Ibrahim po ashtu nga Lum i madh. Kjo ndodhi në Shega, Miloshevë. Sejdi Zeqiri më kërkoi që të shkoja në stacionin e policisë dhe të siguroja që e dyshuara që ishte bashkë me të motrën e saj S të ishin të sigurta. Unë shkova në stacionin e policisë dhe po bëja punë time që të kujdesesha për të dyshuarën. Ishte lëndë sensitive se e dyshuara ishte shumë e re dhe unë u kujdesa për të për një kohë të gjatë. Kjo lëndë u krye përsa i përket hetimeve në orën 3 apo 4 të mëngjezit. Kolegu im dhe unë u larguam nga stacioni i policisë së bashku me të dyshuarën për ta çuar atë në qendrën e paraburgimit.

Prokurori Publik Vendor: Kush ishte kolegu juaj?

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

M P: Nuk jam i sigurtë për emrin. Mund të ketë qenë udhëheqsi i turnit, Petrit Curri apo ndonjë tjetër. Nuk jam e sigurtë. Arsyeja përse nuk jam e sigurtë është sepse në atë kohë unë merresha me të dyshuarën dhe isha gati duke i vendosur në makinë kur u shfaq Sejdi Zeqiri dhe tha, "nuk ka nevojë të shkosh me to. Sonte ti do të vish me mua."

Prokurori Publik Vendor: Ku të shkonit?

M P: Ai tha, "sonte ti je e imja," pa specifikuar çfarë.

Prokurori Publik Vendor: Pyetja ishte, ku synonit të shkonit?

M P: Ne po përgatiteshim të dërgonim të dyshuarit në qendrën e paraburgimit.

Prokurori Publik Vendor: A ishte detyra jote të dërgonit të dyshuarit në qendrën e paraburgimit?

M P: Po, unë shkova tek qendra e paraburgimit. Ne vazhduam të çonim të dyshuarit në qendrën e paraburgimit. Ne e përfunduam procedurën në qendrën e paraburgimit në Prishtinë.

Gjyqtari kryesues: A shkove me makinë në qendrën e paraburgimit apo jo?

M P: Po, me automjetin zyrtar në të cilën ne kishim dy të pandehur.

Prokurori Publik Vendor: Çfarë ndodhi më pas?

M P: Ne përfunduam procedurën në qendrën e paraburgimit dhe unë i kërkova kolegut tim të më conte drejt e në shtëpi dhe jo në stacionin e policisë. Ashtu ndodhi, ai më coi mua në shtëpi.¹

...

Prokurori Publik Vendor: Pas kësaj mbrëmje, si ishin mardhëniet tuaja me komandantin?

M P: Unë nuk kam patur kurrë mardhënie të mira me komandantin tim.

Prokurori Publik Vendor: Ju përmendët se nuk keni patur kurrë një mardhënie të mirë me komandantin tuaj, pra kjo aludon që ju keni patur mardhënie të këqija me të. A mund të na e shpjegosh si ishin këto mardhënie?

M P: Unë nuk e di se si mund të kesh mardhënie të mira me dikë, që sapo paraqitesh në punë je e provokuar, nën presion, dhe çdo herë në prani të oficerëve të tjerë të policisë ai përpigjej të më minonte. Kurdoherë që e shihnim njëri tjetrin apo takoheshim tek vendet e parkimit të policisë ai bënte komente dhe më provokonte me ndonjë mënyrë.

Prokurori Publik Vendor: Të kujtohen ndonjë nga këto fjalë që të janë thënë?

M P: Kjo ndodhte nëse unë isha në detyrë në pozicion të palëvizshëm në hyrje të stacionit të policisë, ai më merrte rregullisht në telefon, në linjën fikse të telefonit. Ai bënte komente, të tilla si, "sot dukesh shumë mirë, përse nuk më dëgjon mua, nëse më dëgjon mua gjërat do të jenë ndryshe".

Gjyqtari kryesues: Le të përqëndrohemi në episode të vecanta.

Prokurori Publik Vendor: A je ankuar për ndonjë nga këto?

M P: Kujt ti ankoheja deri në këtë moment të tanishëm?

Prokurori Publik Vendor: A ndërmore ndonjë veprim ti vetë?

M P: Jo.

Prokurori Publik Vendor: A kërkove të takoheshe me komandantin?

M P: Po. Ka qenë dikur në mes të 2006. Unë po punoja në turnin e pasditës me kolegun Naim Mulaku. I kërkova udhëheqësit të turnit, komandantit në zinxhirin komandues, Enver Mjekiqit, që të më caktonte një takim me komandanin me që doja të flisja me të. Mu kërkua nëpërmjet radios të kthehesha në Shtab me kolegun tim Naim Mulaku. Unë shkova në zyrën e komandantit dhe e pyeta përse i bënte këto lojra me mua, pse bënte lojra dhe përpigjej të më bënte mua subjekt të përqeshjeve në stacionin e policisë, sidoqoftë ai nuk arriti ta bëjë këtë me mua. Ne po bënim një bisedë, situata ishte në rregull, unë i kërkova sqarime.

Prokurori Publik Vendor: A kishte ndonjë person tjetër të pranishëm?

M P: Jo.

Prokurori Publik Vendor: Të kujtohet biseda?

M P: Po, e pyeta për sqarime dhe i kërkova të më linte rehat. Thjesht.

¹ Procesverbali i shqyrtimi kryesor të 18.10.2010 faqet 12-13

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Prokurori Publik Vendor: Cila ishte përgjigja e tij?

M P: "Hajde, do të jetë më mirë". Ai ishte ironik dhe cinik. "do të jetë më mirë, këto gjëra mund të bëhen". Më kujtohet atë moment unë isha e ulur në karrike dhe ai u ul pranë meje dhe u përpoq të më puthë.

Gjyqtari kryesues: A ta mori dorën apo jo?

M P: Ai erdhi nga pas dhe u përpoq që të më puthë. Unë u ngrita në këmbë. Situata u përkeqsua. E di që ai më mbërtheu nga dora dhe më shtyu. Më kujtohet shumë mirë që i thashë atij se do të ankohesha kundër tij kudo që të mundja.

Gjyqtari kryesues: Kur the që ai u përpoq të puthte, a të preku ai me buzët e tij apo jo?

M P: Ai u përpoq të më puthë dhe të më prekë fytyrën. Ai do ta kishte arritur këtë nëse do ta kisha lënë ta bënte këtë.

Gjyqtari kryesues: Po, a arriti ai të puthë apo jo? Ne nuk ishim aty, prandaj po përpiqemi që ta kuptojmë.

M P: Ai arriti.

Gjyqtari kryesues: Cilën pjesë të trupit tënd preku ai me buzët e tij? E kuptoj që mund të jetë e dhimbshme për ty që të kujtosh të gjithë këto hollësi. Ti duhet të jesh sa më e saktë që të mundesh. Ne duhet të ndërhyjmë sepse ne duhet të zbulojmë çfarë ndodhi. Ju lutem, përgatituni që ne do të bëjmë shumë pyetje. Ne na duhet të shkojmë në hollësi. Këshut duhet të jenë gjërat. Me që ju thatë se ai arriti të prekë ty me buzë, çfarë pjese e trupit tënd u prek?

M P: Fytyra.

Gjyqtari kryesues: Në cilën pjesë?

M P: Në faqe.

Gjyqtari kryesues: Pastaj çfarë ndodhi?

M P: Situata u përkeqsua dhe unë i thashë do të ankohesha ku të mundja.

Gjyqtari kryesues: A bërtite ti, apo çfarë bëre?

M P: E di që u largova nga zyra e tërbuar dhe oficerët e policisë Naim Mulaku dhe Enver Mjekiçi që ishin jashtë më dëgjuan që të zbrisja nëpër shkallë. Unë doja të ikja nga ndërtesa por më ndaluan këta të dy.

Gjyqtari kryesues: Dua të di nëse bërtite mbasi ai bëri përpjekjen për të puthur.

M P: Unë e thashë që e shtyva atë.

Gjyqtari kryesues: Pra ti nuk bërtite?

M P: Jo, por ne filluam të flasim me zë më të lartë dhe situata po dilte nga duart. Më kujtohet se në një moment, nëse nuk gaboj, ai më vuri dorën në gojë dhe kjo është një nga gjërat që unë e mbaj mend saktësisht.

Gjyqtari kryesues: A të vuri vetëm dorën në gojë ai, apo kreu po ashtu veprime të tjera?

M P: Jo, ai më vuri një dorë në gojën time dhe tha, "mjaft se ndryshe do ta shqyjej gojën".

Gjyqtari kryesues: Përpara policisë ai tha, "Përse bërtet, ti duhet ta kesh për nder që unë dua të jem me ty?"

M P: Ashtu ka ndodhur.

Gjyqtari kryesues: Pra e konfirmoni që i pandehuri i ka thënë këto fjalë?

M P: Po. Mendoj se ai insinuoonte "kush je ti të më refuzosh mua. Ti duhet të jesh e nderuar që unë dua të jem me ty."

Gjyqtari kryesues: A the ti ndonjë gjë?

M P: Më kujtohet që nuk ju drejtova atij si komandant apo oficer, por i thashë, "Sejdi Zeqiri unë nuk kam frikë nga ti" Mua nuk më kujtohen të gjithë fjalët që thashë.

Gjyqtari kryesues: A ta mori revolverin në atë rast?

M P: Jo.

Gjyqtari kryesues: Në dëshminë që keni dhënë në polici është shkruar se i pandehuri pa hezitim më mbërtheu revolverin dhe dorën tjetër ma vuri në gojë dhe tha fjalët që sapo dëgjuam.

M P: Nuk mendoj se kam thënë se ma mbërtheu revolverin, është e mundshme ai vuri dorën e tij në dorën time me që mendoj se unë mund të shkoja për armën.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Gjyqtari kryesues: Pra ai vuri dorën e tij në dorën tënde kur dora jote ishte tek revolver?

M P: Po, unë e spjegova më parë, dora ime po mbështetej tek revolveri dhe se në atë moment ai vuri dorën e tij tek dora ime dhe dorën tjetër në gojën time.

Gjyqtari kryesues: Është e qartë.

Prokurori Publik Vendor: Cfarë ndodhi pasi u largove nga zyra?

M P: E di që humba kontrollin. Më kujtohet një gjë tjetër. Kur isha në zyrë ai tha se “Unë këtu jam Zoti dhe ti nuk mund të bësh asgjë. Ti nuk mund të ankolesh kundër meje askund”.²

Nga tregimi i dëshmitarit del se, pikërisht në 2004 (është episodi i raportuar në procesverbalin e 18 Tetorit 2010, faqet 12-13), i pandehuri i ishte vardisur palës së dëmtuar dhe ajo e kishte refuzuar. Episodi, përderisa ishte një vardisje e thjeshtë pa ndonjë kontakt fizik, nuk ka relevancë në kuptim të përgjegjësisë penale për të pandehurin, por ndihmon të qartësojë kontekstin dhe mardhëniet midis të pandehurit dhe viktimës.

Vardisjet u bënë më agresive në 2006 (është episodi i raportuar në 18 Tetor 2010, faqet 15-18) dhe përfundoi në një kontakt fizik dhe një puthje të padëshiruar nga pala e dëmtuar. Kjo puthje e bën të qartë se cili ishte qëllimi i të pandehurit.

Duhet të vërehet se nuk ka dyshim që pala e dëmtuar kaloi një periudhë të vështirë pas episodit të mësipërm përderisa ajo kërkoi ndihmë tek psikologji sic është vërtetuar nga certifikata mjeksore e datës 5 Gusht 2008 që vërteton se ajo është vizituar nga mjeku neuropsikiatër Ferid Agani (mbrojtia pretendoi se gjykata i kishte deklaruar certifikatat mjeksore të papranueshme; në fakt aktvendimi i trupit gjykues thotë se certifikatat mjeksore të paraqitura nga pala e dëmtuar ishin të pranueshme, por e kishte kufizuar lidhshmërinë e tyre në faktin se pala e dëmtuar kishte patur disa vizita mjeksore dhe në tipologjinë e vizitës)³.

Meqenëse akuza është e bazuar vetëm në një dëshmi, natyrisht që është e qartë se trupi gjykues duhet të jetë shumë i kujdesshëm në lidhje me vlerësimin e tregimit.

Më konkretisht dëshmia nuk duhet të tregojë mospërputhje dhe paqëndrueshmëri të brendshme dhe të jashtme. Dhe kur dëshmia i reziston një prove të tillë atëhere nuk ka pengesa për ta mbështetur dënimin vetëm në bazë të një dëshmie (parimi mesjetar *unus testis nullus testis* nuk ka vlerë në ligjin penal modern).

Sipas mendimit të trupit gjykues dëshmia e palës së dëmtuar duket të jetë në brendësinë e saj koherente: në fakt ajo spjegoi me saktësi, dhe pa ndonjë kontradiktë relevante, për çfarë i ndodhi asaj në zyrën e të pandehurit në episodin e veçantë që ndodhi në vitin 2006. Për më tepër dëshmia përpara gjykatës ishte në tërësi në përputhje me deklaratën që ajo dha gjatë fazës hetimore dhe kjo i jep një peshë shtesë besueshmërisë së dëshmisë. Po ashtu duhet të merret në konsideratë, përse i përket vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarit, vështirësia e kuptueshme dhe stresi për një oficer policie e një rangu të ulët (duke patur parasysh hierarkinë strikte të policisë) që të akuzojë mbikqyrësin apo komandantin e saj.

² Procesverbali i shqyrtimit kryesor i 18.10.2010 faqet 15-18.

³ Procesverbali i shqyrtimit kryesor i 24.1.2011 faqe 3.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Sigurisht, që nuk duhet të ketë qenë e lehtë për M P për të vendosur që të reagonte ndaj sjellies së keqe të komandantit të saj dhe ta dononcojë atë për bëmat e gabuara të tij.

Në lidhje me qëndrueshmërinë e jashtme të dëshmisë, rrethana e vetme që nuk ka dëshmitarë të tjerë për të konfirmuar versionin e palës së dëmtuar, nuk mund të përbëjë një arsye për ta konsideruar këtë tregim si të pprovuar. Në fakt është e qartë për arsye të dukshme se sjelliet që përbëjnë vardisjet seksuale rrallë ndërmerren në prani të njerëzve të tjerë.

Megjithatë, vlen të përmendet se ankesat ndaj të pandehurit rreth sjellies së tij keqtrajtuese dhe tendencës së tij për t'ju drejtuar grave në mënyrë disa herë të papërshtatshme, disa herë haptazi drejtuar për të patur afërsi seksuale, i janë bërë jo vetëm M s, por gjithashtu oficerëve femra të policisë dhe grave (qytetare të thjeshta). Prandaj episodi i denoncuar nga M P nuk është i vetmi, por është vetëm një nga disa episode në të cilat i pandehuri është përfshirë dhe akuzuar për sjellie të këqia ndaj grave.

Shumica e këtyre episodeve do të vlerësohen dhe do të rikonstruohen në tërësi në vazhdimin e arsyetimit: të gjitha ato tregojnë tendencën e të pandehurit për të keqtrajtuar dhe vardisur kolegeve të tij femra.

Episodi që ka të bëjë me K H n, meqenëse akuza është tërhequr nga Prokurori, nuk do të analizohet në vecanti, por ajo mund të vlejë për të kuptuar se cili ishte qëndrimi i komandantit ndaj grave.

Në fakt K H foli qartë për një ftesë të papërshtatshme që vinte nga komandanti dhe rreth sjellies ngacmuese që ai kryente.

Procesverbali i dëshmisë së K H flet vetë:

Prokurori Publik: Të kujtohet një episod në 2007 që ka të bëjë me komandantin tënd?

K H: nëse bëhet fjalë për një telefonatë. U kontaktova pas orarit të punës.

Prokurori Publik: A është normale që komandanti të marrë në telefon pas orarit të punës?

K H: Për mua nuk ishte normale/e zakontë. Nuk ishte e zakonshme gjithashtu në kontekst për shkak sepse në stacionin e policisë ai më dëmtonte duke më krijuar stres. Kur më thërriti fillimisht, fjalët e mija të para ishin – të lutem mos më telefono nëse nuk është dicka zyrtare. Unë kam mjaft probleme me gjendjen financiare dhe probleme me fëmijët. Ai më tha se jo-zyrtarisht ai dëshironte të pinte një kafe me mua. Unë i thashë se nëse më fton bashkë me burrin do të thoja po. Burri im punon në të njëjtin stacion policor. Ne kishim gjëra të përbashkëta.

Gjyqtari kryesues: cila ishte përgjigja e të pandehurit?

K H: Nuk më kujtohet saktësisht se si ishte, por unë e di se përgjigja ime ishte nëse burri im do të ftohet, po, si shokë.

Prokurori Publik: cfarë ndodhi më pas?

K H: më pas ai mori në telefon burrin tim që të pinim kafe. Ne takuam disa shokë të burrit tim që ishin atje. Pas pak unë shkova në shtëpi kështu që unë e lashë burrin dhe ish komandantin atje.

Prokurori Publik: të kujtohet ku pitë kafe?

K H: ishte jashtë Obiliqit por mua nuk më kujtohet se ku.

Gjyqtari kryesues: Pas këtij takimi, a pati më telefonata?

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

K H: Ai më telefonoi edhe një herë tjetër. Ne shkuam të pijmë kafe përsëri dhe unë vura re si dicka nuk ishte në rregull. Burri im dhe ish komandanti folën me njëri tjetrin por unë nuk isha e pranishme kështu që nuk e di sa çfarë u tha.

Gjyqtari kryesues: pas këtij takimi si ishte situata midis teje dhe komandantit?

K H: jo aq mirë. Ai ma ndryshoi vendin e punës dhe më pas u u caktova si oficer policie në patrullë. Ai vazhdoi të ishte arrogant ndaj nesh. Ai nuk i kryente detyrimet e tij të punës ashtu sic duhej, por sillej si mbret.⁴

...

K H: U përdorën disa fjalë, fjalë të përmendura që ishin agresive.

Avokati Sadri Godanci: Kjo është e gjitha?

Gjyqtari kryesues: Mund të na thoni, kur flisni për fjalë agresive, cilat fjalë u përmendën?

K H: Çfarë është kjo? Çfarë po bën? Vërtetë e ke apo a je normal? Mua nuk më kujtohen saktësisht se si janë thënë. Ka patur raste që kur shkoja në shtëpi qaja për shkak të stresit dhe tensionit të krijuar atë kohë. Unë isha shumë e stresuar dhe traumatizuar për shkak të presionit që ai bënte. E deklaroj me ndërgjegje të plotë, ai sillej si një diktator klasik.⁵

Për më tepër qëndrueshmëria e dëshmisë së M P nuk është lëkundur nga justifikimet e dhëna nga i pandehuri, meqenëse ato paraqiten të dobëta dhe të pabazuara.

Në fakt, sipas të pandehurit, arsyeja përse M P bëri akuzime të rreme kundër tij paraqiten si më poshtë:

Sejdi Zeqiri: M P më denoncoi sepse unë ja ndryshova turnin që ajo shkonte gjithmonë me Enver Makiqin dhe unë vendosa ndryshe.

Gjyqtari kryesues: Pra nuk ishte e lidhur me notat e këqija që ajo kishte marrë?

Sejdi Zeqiri: Jo vetëm për notat e këqija, por më tepër lidhur me ndryshimin e turnit.

Gjyqtari kryesues: Pra ndryshimi i turnit dhe pak notat e këqija?

Sejdi Zeqiri: Po.⁶

Megjithatë, duket shumë e pamundur që pala e dëmtuar vendosi ti bëjë akuzë të rreme komandantit të saj, kryesisht sepse asaj i ishte ndërruar turni.

Përkundrazi, duket më tepër e mundshme që dicka vërtetë e rëndësishme ndodhi midis viktimës dhe komandantit, dicka kaq e madhe sa që ajo preferoi të pranonte një stres psikologjik shumë të madh duke akuzuar komandantin e saj, në vend që të përpiqej që ta harronte episodin: dicka e tillë si vardisje seksuale që e kalon kufirin dhe që arrin nivelin e shpërdorimit seksual.

Duhet të vihet në dukje gjithashtu se arsyeja tjetër e dhënë nga i pandehuri për të spjeguar akuzimet ndaj tij (notat e ulta në lidhje me rezultatet në punë të M s) është e dobët dhe e papërputhshme. Përderisa notat viheshin nga udhëheqësit e turnit dhe përderisa i pandehuri nuk e ka ndryshuar kurrë vlerësimin e mësipërm (sic është spjeguar nga vetë i pandehuri)⁷, M duhet të kishte arsye për tu hakmarrë kundër udhëheqësve të turnit dhe jo kundër të pandehurit.

⁴ Procesverbali i 18 Tetorit 2010, faqe 35-36.

⁵ Procesverbali i 18 Tetorit 2010, faqe 39.

⁶ Procesverbali i 5 Prillit 2011, faqe 11.

⁷ Procesverbali i 5 Prillit 2011.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Për me tepër përputhshmëria e jashtme dhe besueshmëria e dëshmitares nuk duket të lëkundet nga dëshmitarët (Naim Mulaku⁸, V H⁹, Sejdi Haxholli¹⁰, Sevdije Borovci¹¹ dhe Fikrije Misini¹²) të paraqitur nga mbrojtja.

Është e vërtetë që të gjithë ata e përshkruajnë të pandehurin si një oficer policie dhe komandant model, por në stacionin e policisë së Obiliqit punonin 70 oficerë policie dhe kështu që është shumë e mundur dhe llogjike që i pandehuri kishte sjellie të tilla keqtrajtuese jo ndaj të gjithëve, por vetëm ndaj disave. Në fakt përshkrimi i sjellies së të pandehurit nga palët e dëmtuara është krejt i ndryshëm.

Për më tepër, sic është theksuar me lart, një episod i shpërdorimit seksual zakonisht nuk ndodh përpara njerëzve të tjerë dhe ka pak gjasa që viktima të ketë vullnetin të flasë për këtë me të tjerët, me përjashtim të rasteve kur janë vërtetë shumë të afërt.

Përderisa dëshmitarët e mësipër nuk kanë parë asgjë, ata hezitonin qartazi të besonin që komandanti kishte kryer të tilla gjëra.

Në dëshminë e saj Fikrije Misini shtoj dicka tjetër që duhet të merret në konsideratë. Oficerja e policisë, që ka punuar si asistente e komandantit, deklaroi se dera e zyrës së komandantit ishte zakonisht e hapur dhe se mbyllej vetëm kur bëheshin takime të një rëndësie të caktuar (të tilla si me përfaqësuesit e KFOR-it apo EULEX-it)¹³.

Nga mënyra se si është kryer egzaminimi, del e qartë përpjekia e mbrojtjes për të provuar që dera e zyrës së komandantit nuk rrinte kurrë e mbyllur (dhe në këtë mënyrë një shpërdorim seksual nuk mund të ndodhte kurrë).

Megjithatë, qëndrueshmëria e teorisë është vënë seriozisht në dyshim nga pyetjet e drejtuara nga trupit gjykues:

Gjyqtari kryesues: Ju thatë se kur ai pranonte oficerët e tjerë të policisë në Stacionin e policisë dera ishte zakonisht e hapur?

Fikrije Misini: Po, gjithmonë.

Gjyqtari kryesues: E përjashton atë që në raste të vecanta dera ishte e mbyllur?

Fikrije Misini: Ishte e hapur gjatë të gjithë kohës.

Gjyqtari kryesues: E përjashton atë që në raste të vecanta ka ndodhur që dera ishte e mbyllur?

Fikrije Misini: Nuk e di, por mund të them se dera është mbyllur vetëm kur ai kishte takime shumë të rëndësishme.

Gjyqtari kryesues: Në lidhje me pyetjen time, je në gjëndje ta përjashtosh këtë apo jo?

Fikrije Misini: Jo.¹⁴

...

Gjyqtari kryesues: A qëndroje gjithmonë e ulur në atë tavolinë për të kryer detyrat, apo ndonjë herë duhej të largoheshe nga dhoma për të shkuar në dhoma të tjera në Stacionin e Policisë?

Fikrije Misini: Jo, unë nuk kisha detyra që të më bënë të shkoja në zyra të tjera. Unë jam gjithmonë në zyrën time, edhe sot unë jam gjithmonë në zyrën time.

⁸ Procesverbali i 10 Dhjetorit 2010.

⁹ Procesverbali i 10 Dhjetorit 2010.

¹⁰ Procesverbali i 17 Dhjetorit 2010.

¹¹ Procesverbali i 17 Dhjetorit 2010.

¹² Procesverbali i 1 Prillit 2011.

¹³ Procesverbali i 1 Prillit 2011, faqe 5.

¹⁴ Procesverbali i 1 Prillit 2011, faqe 9.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Gjyqtari kryesues: A keni ju pushim në drekë?

Fikrije Misini: Po, nga 12-1.

Gjyqtari kryesues: Po ndonjë pushim kafeje gjatë ditës?

Fikrije Misini: Kemi, por unë nuk shkoj kurrë në pushimet e kafesë.

Gjyqtari kryesues: Pra përvec pushimit të drekës, ju qëndroni 7-8 orë e ulur në tavolinë tuaj?

Fikrije Misini: Po, e ulur ose në zyrën e komandantit unë bëj ndarjen e dokumentave në dosje.

Unë kam shumë punë për të bërë.

Gjyqtari kryesues: Na e ke thënë, por e harova, sa kohë ke punuar me komandant Sejdi Zeqirin?

Fikrije Misini: Pesë vjet.¹⁵

Nga këto pjesë të shkëputura, së pari dëshmitarja mundi vetëm të thotë se dera ishte zakonisht e hapur, por nuk mundi të përjashtojë se në disa raste të tjera (të ndryshme nga takimet që tregoi dëshmitarja) dera ishte e mbyllur.

Për më tepër, duket mjaft e vështirë të pranohet që në pesë vjet dëshmitarja të mos ketë lëvizur kurrë nga tavolina e saj, që është përballë derës së komandantit, për të patur një pushim të shkurtër për kafe apo për pak shplodhje. Kjo hedh një hije në të gjithë dëshminë që duket të jetë shumë e njëanshme në favor të komandantit.

Prandaj dëshmitë e mësipërme të paraqitura nga mbrojtia janë neutrale në lidhje me vlerësimin e dëshmisë së M P.

Në të kundërt, ajo çfarë ka rëndësi është se për të çvlerësuar dëshminë e M P, paraqitet ideja e një komploti gjigand kundër komandantit krijuar nga një grup grash dhe nga një numër burrash që kanë shtuar akuzime të tjera të rreme. Këta burra dhe gra, secili nga ata për arsye dhe qëllime të ndryshme, duhet të kenë krijuar një lloj koalicioni kundër komandantit të stacionit të policisë së Obiliqit dhe vendosën ta akuzojnë atë me akuza të rreme.

Në fakt kjo është mbrojtur edhe nga avokatët mbrojtës dhe vetë i pandehuri, i cili deklaroi të ishte viktimë e një komploti për shkak se kishte arrestuar një Shqiptar që kishte provokuar disa Serbë gjatë një manifestimi publik.¹⁶

Ky spjegim duket i pabesueshëm, i pabazuar dhe në fund i pa qëndrueshëm në lidhje me versionin llogjik dhe të qëndrueshëm të dhënë nga pala e dëmtuar.

Për arsyet e mësipërme, trupi gjykues është i mendimit se dëshmia e M P është e qëndrueshme, e prerë, solide dhe e besueshme se në fakt i pandehuri rreth mesit të vitit 2006 e ka prekur dhe puthur për qëllime seksuale.

* * *

Në lidhje me kualifikimin ligjor, del e qartë se sjellia e kryer nga i pandehuri duhet të klasifikohet si Shpërdorim Seksual në shkelje të Nenit 200 paragrafi 2, pika 1 të KPK. Në fakt veprimi i puthjes së një gruaje në mënyrën se si është përshkruar më lart sigurisht përbën atë që ka patur "prekje" në kuptimin e paraparë nga Neni 192, paragrafi 5 dhe 200 paragrafi 2 të KPK.

¹⁵ Procesverbali i 1 Prillit 2011, faqe 10.

¹⁶ Procesverbali i 1 Prillit 2011, faqet 26-27.

Është e padiskutueshme gjithashtu se puthja e mësipërme është kryer me qëllim seksual. Mardhëniet midis viktimës dhe të pandehurit, që nuk ishin miqësore, dhe mënyrën se si u dha puthja (drejtuar për tek buzët dhe kapja e dorës së viktimës) nuk le ndonjë dyshim se cili ka qenë qëllimi i të pandehurit.

Për më tepër duhet vënë në dukje se sjellia e të pandehurit ishte kryer duke shpërdoruar kontrollin që ai kishte mbi punësimin dhe të punës së viktimës në përgjithësi (fakti që kjo ndodhi në zyrën e të pandehurit dhe takimi midis tij dhe viktimës ishte mbajtur për çështje që lidheshin me punën).

Në këtë mënyrë, është e qartë se lidhur me episodin në fjalë, të dyja *actus reus* dhe *mens rea* janë provuar përtej dyshimit të arsyeshem.

2.2. Episodi që përfshin K Hn (pika 2 e aktakuzës).

Në lidhje me episodin e mësipërm, Prokurori në shqyrtimin kryesor të datës 5 Prill 2011 tërhoqi akuzimet dhe në këtë mënyrë, sipas Nenit 389, pika 1 e KPPK, ngarkimi penal duhet të hidhet poshte.

2.3. Episodi që përfshin V Gn (pika 3 e aktakuzës).

Në lidhje me episodin e mësipërm, e vetmja provë e paraqitur nga Prokurori ishte dëshmia e dhënë nga pala e dëmtuar. Më poshtë po paraqisim pjesën më relevante të dëshmisë së saj:

V G: Ka qenë rreth Majit apo Qershorit 2008, kur unë u ktheva nga leja e lindjes. Fillimisht unë punova turne të shkurtëra. Kjo duhet të ketë përfunduar afërsisht pas gjashtë muajsh, dhe duhet të kem shkuar në rutinën e zakonshme të punës, dhe një javë përpara se duhet të ketë filluar ky ndryshim, unë shkova në zyrën e tij, nuk e di nëse ai më ftoi apo kam shkuar vetë, por kishte të bënte me punën e re dhe unë duhet të kem bërë një propozim atë kohë për turnin.

Prokurori Publik Vendor: Si shkoi takimi?

V G: Nuk ishte shumë i mirë.

Prokurori Publik Vendor: Përse, çfarë ndodhi?

V G: Gjatë bisedës që pata me të reth ndryshimit të turnit, unë po qëndroja në këmbë jo shumë larg derës. Toger Sejdë Zeqiri ishte ulur në karrike në zyrën e tij, ai u çua, erdhi në drejtimin tim, më erdhi shumë pranë, më pas më vuri duart në shpinë, në atë anë, erdhi shumë pranë meje – unë nuk e di se si mund ta kuptoni ju këtë, por përfundoi ashtu sic e kam përshkruar në deklaratën tim. Ai nuk më puthi ashtu, por dukej sikur ai po përpigjej ta bënte atë. Në fakt një nga arsyet që jam këtu është sepse doja të dija qëllimet e tij sepse nuk kam patur kurrë rast ta pyes atë për këtë. Unë jam e bindur se ai donte të më puthte mua, nga mënyra se si mu afrua.

Prokurori Publik Vendor: A të preku?

V G: Ma hodhi dorën përreth shpinës në anën time të djathtë; mund të ketë qenë një lloj prekje. Unë nuk jam e sigurtë sepse hapa derën menjëherë dhe u largova.¹⁷

...

V G: Kur mu afrua, ai ma hodhi dorën rreth meje; fytyra e tij do të ketë qenë po ashtu pranë asaj times.

Gjyqtari kryesues: Pate mundësinë të shihje fytyrën e tij apo jo?

V G: Nëse merrni në konsideratë se unë isha shumë e stresuar dhe se ishte një moment shumë i shkurtër; fytyra e tij ishte afër meje.

¹⁷ Procesverbali i 21 Tetorit 2010, faqet 4-5.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Gjyqtari kryesues: Nëse një person ti vendos duart në shpatull kjo nuk do të thotë se ai do të puthë. Unë dua të di – sipas mendimit tënd – nëse ai u përpoq të të puthte.

V G: Shumë e thjeshtë. Unë jam grua, ai është burrë, ai mu afrua dhe ai më vuri duart rreth meje. Ne nuk ishim miq kështu që është shumë e thjeshtë për ta kuptuar.

Gjyqtari kryesues: Ndoshta për ty, por jo për mua. Përvec faktit që je grua, si mund ta kuptoje që ai donte të puthte ty? A ishte për shkak sepse ai t'ii vuri duart në shpatulla dhe të erdhi tu afrua shumë?

V G: Ai mu afrua dhe më vuri duart tek shpatullat. Unë nuk kisha miqësi me të, kështu që unë nuk e di se çfarë të prisja tjetër.

Gjyqtari kryesues: Vendosja e duarve në shpatulla mund të ketë qenë një gjest miqësor.

V G: Unë nuk kam miqësi me të. Unë nuk i dija qëllimet e tij, por atje dhe nëse nuk do të isha larguar ai do të më kishte puthur.¹⁸

Nga kjo pjesë e shkëputur e procesverbalit, duket të ketë qenë vetëm një episod që ka të bëjë me akuzimin, ai që ka ndodhur në Maj (ose Qershor) 2008. Dëshmitari tregoi qartë pa asnjë hezitim se komandanti ja vendosi një krah në shpatull dhe u përpoq ta puthë atë (fjalë e fundit e procesverbalit flet vetë).

Në lidhje me besueshmërinë e dëshmisë së mësipërme, konsiderimet e paraqitura për dëshminë e M P vlejné po ashtu për V G n (që është gjithashtu oficer policie) dhe kështu që do të theksohen vetëm ndryshimet.

Në lidhje me qëndrueshmërinë e brëndshme të dëshmisë, ka një ndryshim të dukshëm midis dëshmisë së dhënë përpara gjykatës dhe asaj të dhënë nga ajo gjatë hetimeve.

Në fakt, në këtë të fundit është thënë se viktima ishte prekur në gjoksin e saj (“kraharor” në deklaratën e saj origjinale në Shqip, që sic u sqarua në seancën e shqyrtimit kryesor nga përkthyesi nënkupton në fakt “gjoksin”), ndërsa përpara trupit gjykues pala e dëmtuar raportoi se ajo ishte prekur në shpatulla.

Megjithatë, duke patur parasysh praninë e cështjeve të komplikuarra linguistike lidhur me ndryshimet në fjalët Shqipe “kraharor”, “gjoks”, “kraharorin”, “krah”¹⁹, sigurisht është më e saktë që të mbështetemi në deklaratën e dhënë nga pala e dëmtuar përpara gjykatës, meqenëse ishte shumë e qëndrueshme, solide dhe e prerë. Dëshmitarja i tregoi gjykatës shumë qartë lëvizjen e bëra nga i pandehuri për ti vendosur dorën në shpatull dhe të përpiquej ta puthë atë.

Fakti që ajo mohoi ta kishte prekur në gjoks (edhe pse ajo i konfirmoi akuzat e saj), i jep dëshmitares më tepër besueshmëri, duke treguar se nuk ka patur qëllime për tu hakmarrë kundër të pandehurit (sigurisht që sjellia e të pandehurit do të kishte qenë shumë më e rëndë nëse ajo do të kishte konfirmuar se ajo ishte prekur në gjoks).

Konsiderimet e bëra lidhur me dobësinë e provave të paraqitura nga mbrojtia për të lëkundur besueshmërinë e M P vlejné edhe për V G n, por duhet të theksohen disa ndryshime.

¹⁸ Procesverbali i 21 Tetorit 2010, faqe 10.

¹⁹ Procesverbali i 21 Tetorit 2010, faqe 8-9.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Për të spjeguar përse pala e dëmtuar ka bërë akuzime të rreme ndaj tij, i pandehuri paraqiti tre arsye të vecanta.

Arsyeja kryesore ishte përafërsisht e njëjtë me atë që kishte të bënte me M P: V nuk ishte transferuar nga Komandanti në njësinë që ajo kishte kërkuar dhe kështu që ajo donte të hakmerrej (dhe përsëri, rrethana që pala e dëmtuar vendosi të ndërmarrë rrezikun për ta akuzuar në mënyrë të rreme komandantin e saj vetëm sepse kërkesa e sa nuk ishte plotësuar, duket të jetë shumë e pamundur).

Më poshtë paraqisim një pjesë të procesverbalit që është relevant:

Gjyqtari kryesues: Po për V G n, cila ishte arsyeja sipas mendimit tënd që ajo të ka akuzuar në mënyrë të rreme?

Sejdi Zeqiri: Jo vetëm sipas mendimit tim, por unë jam pothuajse i sigurtë se arsyeja ishte se unë nuk e transferova atë në njësinë e hetimit apo të punonte me komunitetin në turnin e parë.²⁰

Arsyet e mëtejshme të dhëna nga i pandehuri ishin si më poshtë:

Gjyqtari kryesues: ...dhe fakti që kunati i saj ishte arrestuar?

Sejdi Zeqiri: Po.

Gjyqtari kryesues: Kush e arrestoi kunatin e saj?

Sejdi Zeqiri: Ekipi i komunitetit sepse ata u thërritën nga drejtori i shkollës që u ankua se një person kishte ardhur të rrahë një mësuese

Gjyqtari kryesues: Ishe ti i përfshirë në arrestimin apo hetimin kundër tij?

Sejdi Zeqiri: Drejtori më telefonoi mua në fillim dhe unë më pas dërgova atje një njësi.

Gjyqtari kryesues: I dhe urdhër ti njësisë të arrestojë njerëz, apo thjesht dërgove njësinë?

Sejdi Zeqiri: Njësia shkon në vendngjarje për të parë çfarë ka ndodhur dhe në fakt ata e prunë atë në stacionin e policisë.

Gjyqtari kryesues: kush vendosi ta arrestonin këtë person, ti apo oficerë të tjerë të policisë?

Sejdi Zeqiri: Policia kontaktoi Prokurorin Publik ... (u ndërpre)

Gjyqtari kryesues: Ishe ti apo oficerët e tjerë?

Sejdi Zeqiri: Policia e komunitetit.

Gjyqtari kryesues: Pra, nuk ishte ti?

Sejdi Zeqiri: Jo. 80% e oficerëve të policisë janë nga Komuna e Obiliqit, dhe oficerët e policisë i thanë Vs, 'po të ishte për ne, ne do ta lejonim atë të shkonte por komandanti ka kërkuar të vazhdohet me procedurë të rregullt.'

Kryetari i Trupit gjykues: Kush ta tha këtë?

Sejdi Zeqiri: Policia.

Kryetari i Trupit gjykues: Kush? A keni ndonjë emër?

Sejdi Zeqiri: Sejdi Haxholli dhe Sevdije Buroci. Ata kanë biseduar me Vn²¹

...

Kryetari i Trupit gjykues: Cila ishte arsyeja tjetër?

Sejdi Zeqiri: Në një kohë kishte një dasmë në Obiliq, dhe daja i V Gt ka shtënë në ajër me armën e tij. Dhe kur policia ka shkuar te Sejdi Haxholli ai kishte ikur por ai ishte identifikuar si qitësi. Dhe V u ka thënë policeve hetues, 'Mos e kërkonni meqë ai është daja im.' Dhe qartë kjo është thjesht meqë unë vetëm kryeja punën time por kjo pengonte policët e tjerë që ishin të gjithë pjesë e këtij komuniteti të ngushtë të Obiliqit.

Kryetari i Trupit gjykues: Kush e identifikoi këtë dajën e V Gt, ju apo ndonjë polic tjetër?

²⁰ Procesverbal i 5 Prillit 2011, faqet 11-12.

²¹ Procesverbal i 5 prillit 2011, faqe 12.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Sejdi Zeqiri: Polici hetues, Bekim Hyseni. Ai është marrë me rastin.

Kryetari i Trupit gjyqes: A keni qenë ju i përfshirë në këtë hetim të vogël?

Sejdi Zeqiri: Kur jam informuar lidhur me këtë kam kërkuar nga polici, hetuesi, të arrestojë këtë person dhe të konfiskojë armën. Polici ka thënë se e kishin identifikuar personin dhe ai është nga Kacekolle. Pastaj V G i ka thënë hetuesit, 'Mos e kërkoni meqë ai është daja im.'

Prapë, arsyet më lart duken mjaft të dobëta meqë arrestimi i parë nuk ishte urdhëruar nga komandanti, por nga policia e komunitetit në bashkëpunim me Prokurorin. Roli i komandantit ka qenë marginal dhe kjo shpie deri te përfundimi se dy policët me arsye nuk kanë mundur t'i thonë Vs se ishte komandanti ai që ka dashur të vazhdojë me arrestimin.

Sa i përket episodit të dytë, sipas tregimit të të vet pandehurit, nuk rezulton se Valdetja e ka ditur që komandanti ka qenë i përfshirë në rastin, meqë arrestimi është zaptuar nga një polic tjetër.

Dhe, sidoqoftë, përpos dobësisë së shpjegimeve të dhëna nga i pandehuri, vlerësimi i njëjtë sa i përket besueshmërisë, qëndrueshmërisë, koherencës së brendshme dhe të jashtme tashmë të bërë lidhur me dëshminë e M s poashtu vlen edhe për dëshminë e dhënë nga Valdetja.

Prandaj, është mendim i Trupit gjyqes se i pandehuri në maj apo qershor 2008 ka vendosur krahun rreth supeve të V G t dhe është munduar ta puthë.

* * *

Sa i përket kualifikimit ligjor, duket qartë se sjellja e të pandehurit duhet të klasifikohet si Shpërdorim Seksual në Tentativë në kundërshtim me nenet 20 dhe 200, par. 2, pika 1 e KPK.

Në fakt, përderisa akti i thjesht prekjes së supit është i dykuptimshëm, edhe pse plotësisht i papërshtatshëm duke marrë parasysh raportin në mes të të pandehurit dhe viktimës, akti i përpjekjes për të puthur femrën ashtu siç është përshkruar më lart padyshim do të thotë se ka pasur përpjekje për të "prekur" viktimën në kuptimin siç parashihet në nenin 192, par 5 dhe 200 par. 2 i KPK.

Gjithashtu është e pakontestueshme se përpjekja për të puthur ka pasur qëllim seksual. Raporti në mes të viktimës dhe të pandehurit, që nuk ka qenë shoqëror, dhe mënyra se si Zeqiri është munduar të puthë viktimën (duke pasur shënjestër buzët) nuk lë asnjë dyshim sa i përket qëllimit që ka pasur i pandehuri.

Për më shumë, duhet të vërehet se sjellja e të pandehurit është bërë duke shpërdoruar kontrollin e tij mbi punësimin dhe punën në përgjithësi të viktimës (fakti ka ndodhur në zyrën e të pandehurit dhe takimi në mes tij dhe viktimës është mbajtur për çështje pune).

Prandaj, është e qartë se sa i përket ngjarjes aktuale, të dyja, edhe *actus reus* dhe *mens rea* e të pandehurit, janë dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm, duke pasur parasysh se, meqë nuk ia ka arritur të puthë viktimën, vepra penale duhet të ricilësohet si thjesht tentativë.

2.4. Ngjarja që përfshin S K (pika 4 e aktakuzës).

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Sa i përket kësaj ngjarjeje, prova e vetme e prezantuar nga Prokurori është dëshmia e dhënë nga pala e dëmtuar.

Në seancën dëgjimore të 2 nëntorit 2010 S K ka mohuar se nënshkrimi dhe deklarata e shkruar me dorë (pa datë) që i janë treguar asaj nga Trupi gjykues janë të saj.

S K i afrohet Trupit gjykues.

Gjyqtarja, Elmaze Fazliu: A është ky nënshkrimi yt?

S K: Ky nuk është dorëshkrimi im apo nënshkrimi.

Kryetari i trupit gjykues: Pra, ti asnjëherë nuk e ke parë këtë?

S K: Kam dëgjuar për këtë kur kam ardhur këtu në gjykim.

...

Kryetari i trupit gjykues: A insistoni se deklarata e cila u tregua nuk është nënshkruar nga ti, dhe dorëshkrimi uk është i yti?

S K: Po²².

Sa i përket deklaratës më lart, M P ka dëshmuar se shkrimi është i saj, ndërsa nënshkrimi është dhënë nga S, duke specifikuar se derisa kjo e fundit fliste, M ka shkruar atë që i është thënë dhe në fund S ka vendosur nënshkrimin e saj në deklaratë²³.

Deklarata e dhënë nga S në seancën dëgjimore më 2 nëntor ka detyruar Trupin gjykues të emërojë një dëshmitar ekspert i cili me siguri dhe pa dyshime ka deklaruar se nënshkrimi i mësipërm është i S Kt.

V M: Bazuar ne ekspertizen e kryer mbi dokumentin dhe nënshkrimin, arrihet ne perfundimin se nënshkrimi është i S Kt²⁴.

Ekspertiza duket të jetë shkencëtarisht e besueshme dhe e saktë dhe madje nuk është kontestuar nga mbrojtja. Prandaj duhet të vlerësohet se nënshkrimi në deklaratë në fakt i takon S Kt.

Avokati mbrojtës energjikisht ka kërkuar nga Trupi gjykues që të përjashtojë deklaratën (ose më mirë të themi deklaratën me shkrim) e S Kt.

Meqë deklarata e S përbëhej nga tre faqe, dy nga të cilat janë nënshkruar nga ajo ndërsa e treta është e panënshkruar, Trupi gjykues ka vendosur që t'i konsiderojë si provë të pranueshme vetëm dy faqet e para të deklaratës ndërsa e treta është përjashtuar. Aktvendimi gjendet në procesverbalin e seancës dëgjimore të 6 dhjetorit 2010²⁵.

Prandaj, ballafaqimi bazuar në dy faqet e para të deklaratës me shkrim është lejuar dhe në fakt është bërë.

²² Procesverbali i 2 nëntorit 2010, faqe 4-5.

²³ Procesverbali i 19 nëntorit 2010, faqe 10.

²⁴ Procesverbali i 6 dhjetorit 2010, faqe 2.

²⁵ Procesverbali i 6 dhjetorit 2010, faqe 9.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Në dëshminë e saj përpara Trupit gjykues viktima ka mohuar përmbajtjen e deklaratës së saj paraprake dhe gjithashtu ka mohuar se është prekur me qëllim seksual nga i pandehuri.

Më poshtë paraqiten pjesët më relevante nga dëshmia e saj:

Prokurori Publik: Juve deklaruat sot se juve nuk e njihni Sejdi Zeqirin dhe se nuk e keni takur kurre ate. Si e shpjegoni faktin se ne ate deklarate, te cilen juve deklaroni se nuk eshte e juaja, juve keni thene, "E njoh Sejdi Zeqirin. Ai vinte cdo dite ne dyqanin ku punoja une. Ndodhte qe vinte edhe dy here ne dite. Dhe ai shkonte tek kafeneja prane butikut tim dhe sillej ne menyre te papershtatshme me mua. Ai me ka keqperdorur mua dhe situaten ku gjendesha une duke me provokuar me fjalet, "Hej, bukuroshe, hajde neser ne 11 ne zyren time; dua te rri pak me ty. Kam dicka me ty."

Kryetari i Trupit Gjykues: Ju kujtohet tani qe i keni thene keto fjale?

S K: Kjo nuk ka ndodhur asnjehere.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ka ndodhur qe ta keni thene perpara njerezve te tjere?

S K: Jo.

...

Prokurori Publik: Ne Stacionin e Policise juve keni permendur se nuk e keni takuar Sejdi Zeqirin. I referohem perseri kesaj deklarate. Citoj: "Mes te tjerash, ai ka derguar policise ne shtepine time dhe ata me kane urdheruar te shkoj te raportoje ne Stacionin e Policise. Me kane mbajtur ne zyre deri ne tre ore pa marre deklarate dhe ai me tha 'nese do qe ta le rehat familjen tende duhet te flesh me mua' dhe ne ate moment ai ma ka vene doren ne qafe dhe une i thashe atij 'thuaj c'te duash po mos guxo te me prekesh'.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ka ndodhur kjo apo jo?

S K: Jo. Cuditem nga fjalet qe sapo degjova.

Kryetari i Trupit Gjykues: te ka ndodhur qe t'ia kesh thene keto fjale ndokujt?

S K: Jo, sepse nuk ka ndodhur, keshtu qe s'kisha pse ti thoja keto fjale²⁶.

Edhe pse dëshmia e viktimës duket jo e besueshme (ajo qartazi ka gënjyer lidhur me nënshkrimin e saj dhe verzioni që ka dhënë përpara Trupit gjykues dallon kryekëput nga ajo që është thënë në deklaratën e saj të mëhershme) mënyra se si është përpiluar deklarata (e shkruar nga M P e cila ka bërë një lloj përmbledhjeje ta asaj çfarë i ka thënë Selvetja) nuk lejon, në kontekst të pasigurisë së madhe dhe pa ndonjë provë tjetër që konfirmon akuzën sipas aktakuzës, një vlerësim pozitiv të përgjegjësisë së të pandehurit lidhur me këtë ngjarje.

Deklarata e rrejtshme e dhënë nga dëshmitarja lidhur me nënshkrimin e saj do të thotë se ajo do të denoncohet në Prokurori për kryerje të veprës penale të paraparë në nenin 307 të KPK.

* * *

Nuk ka nevojë të bëhen vërejtje lidhur me cilësimin ligjor të bërë nga Prokurori.

2.5. Ngjarja që përfshin Bajram Zeqirin (pika 5 e aktakuzës).

²⁶ Procesverbali i 6 dhjetorit 2010, faqe 10.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Sa i përket ngjarjes më sipër, provat e prezantuara nga Prokurori bazohen në deklaratat e dhëna nga Bajram Zeqiri dhe Nexhip Zeqiri.

Prokurori gjithashtu ka kërkuar dëshminë e Zyra Zeqirit, bashkëshortja e të pandehurit, por ajo ka zgjedhur mos të dëshmojë duke shfrytëzuar mundësinë nga dispozita e nenit 160 par. 1, numër 1 e KPPK.

Më poshtë paraqiten pjesët më relevante nga dëshmia e Bajram Zeqirit:

Prokurori Publik: A ka kërkuar Sejdi Zeqiri diçka nga ju?

Bajram Zeqiri: I kam dhënë 500 Euro Sejdi Zeqirit.

Prokurori Publik: Kur dhe ku ishte kjo?

Bajram Zeqiri: Në vitin 2008.

Kryetari i Trupit Gjykses: Iu kujtohet muaji?

Bajram Zeqiri: Maj ose qershor.

Prokurori Publik: Pse ia dhatë atij këto para dhe ku?

Bajram Zeqiri: I kam dërguar paratë nëpërmjet Western Union-it.

Prokurori Publik: Nga ku?

Bajram Zeqiri: Londër, Angli.

Prokurori Publik: Pse?

Bajram Zeqiri: Sepse ai ishte i gatshëm që të më ndihmonte në lidhje me pronën. Ia dërgova paratë sepse ai ishte i gatshëm që të më ndihmonte ta largoja këtë djalin nga prona.

Prokurori Publik: A iu kishte kërkuar ai këtë?

Bajram Zeqiri: Nëse kishte pyetur, nuk e di. Ishte 50-50.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë po mendon me 50-50?

Bajram Zeqiri: Ai mund të ketë pyetur sepse sikur të mos të kishte pyetur ai nuk i kishte marrë këto para.

Prokurori Publik: Në emër të kujt i keni dërguar këto para?

Bajram Zeqiri: Në emër të bashkëshortes së Sejdi Zeqirit.

Prokurori Publik: E njihni bashkëshorten e Sejdi Zeqirit?

Bajram Zeqiri: Jemi takuar një herë.

Prokurori Publik: Ia dini emrin?

Bajram Zeqiri: Mendoj Zyrah, mendoj se ashtu quhej.

Prokurori Publik: I keni dhënë diçka tjetër Sejdi Zeqirit?

Bajram Zeqiri: Ne kemi dalë, kemi ngrënë dhe kemi pirë diçka.

Prokurori Publik: Rroba?

Bajram Zeqiri: Nuk di gjë për rrobat; mund të ketë qenë një orë. Nuk më kujtohet saktësisht.

Prokurori Publik: Keni shkuar në Grand Store me Sejdi Zeqirin?

Bajram Zeqiri: Po.

Prokurori Publik: Pse shkuar? Për çfarë arsye?

Bajram Zeqiri: Të pimë kafe dhe të mendoheshim, tani më kujtohet se mbase ne i kemi blerë atij diçka.

Prokurori Publik: Çka?

Bajram Zeqiri: Tani nuk më kujtohet saktësisht.

...

Prokurori Publik: Mendoj se ju keni thënë se ju i keni dërguar orë nga Anglia; ju kujtohet se çfarë lloji?

Bajram Zeqiri: Nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: Ishte e juaja apo e keni blerë atë?

Bajram Zeqiri: Orën e kam blerë.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Prokurori Publik: Ju kujtohet se sa keni paguar për atë?

Bajram Zeqiri: Nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: Nuk kam pyetje të tjera.

Prokurori Publik Ndërkombëtarë: Iu kujtohet lloji i orës?

Bajram Zeqiri: Tani nuk më kujtohet.

Prokurori Publik Ndërkombëtarë: A ishte tamam lloji që ai e kërkoi apo e keni blerë vetë?

Bajram Zeqiri: Nuk më kujtohet.

Prokurori Publik Ndërkombëtarë: Nuk kam pyetje të tjera.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Bajram Zeqiri, ju thatë se ju keni dhënë para, ju keni blerë rroba për të pandehurin Sejdi Zeqiri, apo keni blerë mallra për Sejdi Zeqirin, pastaj keni dërguar 500 Euro nëpërmjet Western Unionit në emër të bashkëshortes së tij. Pastaj atij ia keni dërguar një orë, dhe pastaj është një çështje me këto dreka, darka, dhe mbushje telefonike të paguara. A iu kanë dhënë atij të gjitha këto para për çështjen e shtëpisë, çështjen e pronës?

Bajram Zeqiri: Jo të gjithat, por disa prej tyre.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Cilat janë dhënë për çështjen e shtëpisë?

Bajram Zeqiri: Mendoj të kenë qenë këto 500 Eurot.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse ia dërguat orën? Për çfarë arsye?

Bajram Zeqiri: Ia kam dërguar. Ia kam dërguar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju thoni ia keni dërguar, por pse? A kishit marrëdhënie miqësore, a ishte dhuratë miqësie apo diçka tjetër?

Bajram Zeqiri: Më vonë ishte ndërtuar një lloj miqësie; në fillim ia dërgova 500 Euro për ndihmën që ai më ofroi në lidhje me largimin e personit nga shtëpia.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dhe pastaj i janë dhënë këto para, apo ora, për shembull?

Bajram Zeqiri: Siç e thashë edhe më parë, ishte ndërtuar miqësi dhe ishte rezultat i kësaj.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte zgjedhur çështja e pronës kur ju ia dërguat orën apo ende?

Bajram Zeqiri: Nuk më kujtohet saktësisht.

Kryetari i Trupit Gjykses: A iu kujtohet periudha kur keni dërguar këtë, viti pak a shumë?

Bajram Zeqiri: Nuk më kujtohet; mund të ketë qenë para dy vitesh.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ia dërguar orën pasi që ia dërguat atij 500 Eurot nëpërmjet Western Unionit?

Bajram Zeqiri: Mendoj se së pari ia kam dërguar paratë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Deklaratën që ju keni dhënë në shtator të vitit 2009 ju thatë, "Vitin e kaluar i kam dhënë Sejdi Zeqiri 200 Euro që ai të shkonte në deti. Pastaj në janar i kam dhënë atij 100 Euro që të më rregullonte pasaportën." Supozoj që ishte janari i vitit 2009 pasi që ju nuk e keni cekur.

Bajram Zeqiri: Mendoj që po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo orë ishte dërguar pas janarit të vitit 2009 apo para janarit të vitit 2009?

Bajram Zeqiri: Mendoj se ka qenë para janarit.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në janar të vitit 2009 ishte zgjidhur çështja e pronës apo jo?

Bajram Zeqiri: Mendoj që ende jo.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte kërkesa e Sejdi Zeqirit që të kishte ca para apo dhurata nga ju?

Bajram Zeqiri: Jo kur u takuam por unë ia kam dhënë atij.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ishte iniciativa juaj apo Sejdi Zeqiri iu bëri juve që të kuptoni se ai do të donte diçka për këtë intervenim?

Bajram Zeqiri: Diçka e tillë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju po thoni se ndoshta ju e keni kuptuar se ai donte diçka?

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Bajram Zeqiri: Diçka e tillë²⁷.

Sa i përket marrjes në pyetje më lart avokatët mbrojtës në menyrë të pahijshme (njëri nga dy avokatët madje vendosën të largohen nga gjykatorja pa lejen e Kryetarit të Trupit gjykues) siç rezulton nga procesverbali i 17 dhjetorit 2010, kontestuan korrektësinë e marrjes në pyetje, bazuar në certifikatën mjekësore ku thuhej se i pandehuri kishte nevojë për “*regjim shtrati*”.

Certifikata është prezantuar vonë pasdite më 16 dhjetor 2010 dhe, siç rezulton nga procesverbali i 17 dhjetorit 2010, për Trupin gjykues nuk ka qenë e mundur, përpara përfundimit të seancës dëgjimore, të gjejë një kardiolog i cili do të vlerësonte gjendjen shëndetësore të të pandehurit²⁸.

Sidoqoftë, Trupi gjykues ka vendosur të vazhdojë me marrjen në pyetje të dëshmitarit të planifikuar për atë ditë (duhet të vërehet se dëshmitari jeton në Angli dhe se kishte ardhur nga atje specifikisht për këtë seancë dëgjimore), meqë në certifikatën mjekësore të paraqitur nga mbrojtja, nuk thuhej se i pandehuri nuk mund të marrë pjesë në shqyrtim kryesor, por që atij vetëm i duhej pushim dhe kontroll i mëtutjeshëm pas dy jave. Për më shumë, i pandehuri kishte ardhur në gjykatë në mënyrë të pavarur (vetëm) gjë që ka demonstruar që ai plotësisht ka qenë në gjendje të marrë pjesë në shqyrtim kryesor²⁹.

Natyrisht, është e padiskutueshme se në prani të certifikatës e cila nuk cek pamundësinë e të pandehurit për të marrë pjesë në shqyrtim kryesor, Trupi gjykues është ai që vendos nëse ai është në gjendje të bëjë këtë apo jo.

Vlen të vërehet se mbrojtja është përpjekur edhe një herë, përpara seancës dëgjimore të 21 janarit 2011, të pretendojë se i pandehuri nuk është në gjendje të paraqitet në shqyrtim kryesor. Raporti mjekësor i datës 20 janar 2011 qartësisht thotë se i pandehuri ka qenë “*në gjendje të marrë pjesë në shqyrtim kryesor*”, pra, duke konfirmuar vlerësimin tashmë të bërë nga Trupi gjykues.

Prokurori ka kërkuar gjithashtu edhe marrjen në pyetje të vëllait të Bajram Zeqirit, Nexhip Zeqirit.

Megjithatë, Trupi gjykues nuk ka qenë në gjendje të ftojë këtë të fundit, pasi ai nuk jeton më në Kosovë. Raporti i policisë i datës 9.12.2010 ka treguar se ai jeton në Angli (pa specifikuar adresën) dhe i ka ofruar Trupit gjykues një numër telefoni.

Trupi gjykues është përpjekur të kontaktojë dëshmitarin përmes këtij numri, por, siç rezulton nga raporti i këshilltarit ligjor Driton Musliu, i datës 28 shkurt 2011, nuk ka qenë e mundur të kontaktohet Nexhip Zeqiri.

Prandaj, Trupi gjykues ka kërkuar, në pajtim me nenin 368, par. 1, pika 3 për pëlqimin e palëve që dëshmimi i dëshmitarit të zëvendësohet me leximin e deklaratës së tij.

Avokatët mbrojtës nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre dhe, meqë paraqitja e dëshmitarit përfshinte vështirësi të konsiderueshme (nuk ka qenë e mundur apo, sidoqoftë, shumë e vështirë që ai të ftohet), Trupi gjykues ka vendosur të lexojë përmbajtjen e deklaratës në pajtim me nenin 368 par. 1, pika 1 e KPPK.

²⁷ Procesverbali i 17 dhjetorit 2010, faqe 5-6, 10, 11-12 dhe 14.

²⁸ Procesverbali i 17 dhjetorit 2010, faqe 16.

²⁹ Procesverbali i 17 dhjetorit 2010, faqe 3.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Pasi Trupi gjykues lëshoi aktvendimin e tij me qëllim të sigurimit të deklaratës në fjalë, mbrojtja reagoi duke pretenduar se prova është pranuar në kundërshtim me nenin 156, par. 2 të KPPK, i cili thotë *“deklarimi i dëshmitarit i dhënë në polici mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë faze të procedurës penale”*.

Në fakt, është e pamohueshme se në asnjë fazë të procedurës penale mbrojtja nuk ka pasur rastin të marrë në pyetje Nexhip Zeqirin.

Megjithatë, mbrojtja plotësisht ka harruar përmbajtjen e nenit 157 par. 1 të KPPK i cili thotë se:

“Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”.

Domethënia e vetme e mundshme e dy dispozitave me sa duket kundërthënëse është si në vijim.

Neni 156, par. 2 i KPPK vendos një rregull të përgjithshme nga e cila megjithatë ka disa përjashtime. Përjashtimi kryesor është paraparë në nenin 368, par. 1, pikat 1, 2 dhe 3. Në rastet e mësipërme deklarata është provë e pranueshme, edhe pse mbrojtjes nuk i është dhënë rasti të marrin dëshmitarin në pyetje, por, në këto raste, Trupi gjykues është i detyruar sipas kriterit të paraparë në nenin 157 par. 1 i KPPK dhe prandaj deklarata e siguruar si e tillë nuk mund të jetë dëshmia e vetme bazuar në të cilën mund të shpallet fajtor i akuzuari.

Prandaj, sigurimi i deklaratës së mësipërme ka qenë absolutisht i ligjshëm.

Në rastin aktual, i pandehuri është shpallur fajtor bazuar në dëshminë e dhënë përpara Trupit gjykues nga Bajram Zeqiri, ndërsa deklarata e dhënë policisë nga Nexhip Zeqiri është shfrytëzuar vetëm si mbështetje e dëshmisë së Bajramit.

Në deklaratën dhënë policisë, Nexhipi ka shpjeguar se në 2007 familja e tyre ka blerë një shtëpi nga një serb, por prona tashmë ishte e uzurpuar nga një shqiptar me emrin Blerim i cili kërkonte nga ata 15.000 Euro për ta liruar pronën. Për këtë arsye ata kontaktuan të pandehurin i cili u ka thënë se nuk kanë nevojë të paguajnë Blerimin dhe se ai do të zgjidhë çështjen.

Nexhipi ka thënë se për këtë arsye Bajram Zeqiri i ka dhënë disa dhurata të pandehurit si roba, këpucë dhe një orë të blera drejtpërdrejtë nga Nexhipi nga Anglia dhe se vëllai i tij Bajrami i kishte thënë se i kishte dhënë komandantit 2000 Euro me qëllim që të lirohet prona nga personi që e kishte uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

Në fund, në mënyrë që të kompletojë platformën e provave sa i përket kësaj ngjarjeje, Trupi gjykues lëshoi një urdhër për shpalosjen e të dhënave financiare, për periudhën prej 2006 deri 2009, nga xhirollogaritë bankare të të pandehurit, të bashkëshortes së tij dhe të dy dëshmitarëve në mënyrë që të gjurmohen paratë që gjoja janë dhënë nga Bajram Zeqiri bashkëshortes së të pandehurit. Rezultati i urdhrit ishte negativ dhe nuk është gjetur asnjë gjurmë e parave.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Në këtë kontekst mund të bëhen disa konstatime: dëshmia e dhënë nga Bajram Zeqiri, edhe pse përmban disa kundërthënie dhe të meta duhet të konsiderohet si e besueshme sa i përket thelbit të saj, *id est* se dëshmitari i ka dhënë disa para të pandehurit me qëllim të zgjidhjes së çështjes lidhur me pronën që e kishte blerë.

Sa i përket kësaj pike dëshmia ka qenë e sigurtë, e qëndrueshme dhe pa ngurrime. Gjithashtu duhet të merret parasysh se përmes kësaj deklarate dëshmitari e ka inkriminuar veten për veprën penale të Dhënies së Ryshfetit, në kundërshtim me nenin 344 të KPK dhe prandaj dëshmia duhet të konsiderohet si specifiku e besueshme (në fakt, siç rezulton nga fragmentet procesverbalit të mësipërm, dëshmitari nuk ka folur për ndonjë presion të ushtruar ndaj tij nga i pandehuri për të dhënë para, por për një lloj marrëveshjeje në mes atyre dyve).

Në këtë pikë, dëshmia e Bajramit mbështetet nga deklarata e dhënë nga vëllai i tij Nexhipi: në fakt deklarata e ketij të fundit konfirmon se vëllezërit Zeqiri kanë kërkuar nga i pandehuri ndihmë në mënyrë që të zgjidhin çështjen e pronës që e kishin blerë dhe se Bajrami i kishte dhënë të pandehurit ca para për këtë.

Mospërputhja lidhur me shumën e parave të dhëna nga Bajrami komandantit (Bajrami ka dëshmuar duke thënë rreth 500 Euro ndërsa vëllai i tij ka raportuar rreth 2000 Euro) ka shumë gjasa të jetë për shkak të faktit se Nexhipi kur përmend shumën më lart në fakt i është referuar vlerës së përgjithshme të gjësendeve (para dhe dhurata) që i janë dhënë të pandehurit.

Në anën tjetër, sa i përket pikës së përputhjes së dy deklaratave, nuk ka qenë e mundur të gjurmohen, përmes shpalosjes së të dhënave financiare, paratë që gjoja janë dërguar nga Bajrami të pandehurit. Dëshmitari ka deklaruar se paratë janë dërguar përmes Western Union bashkëshortes së të pandehurit, por nuk është gjetur asnjë transaksion në mes të Bajram Zeqirit dhe bashkëshortes së të pandehurit.

Në këtë kontekst kundërthënës, sipas mendimit të Trupit gjykues ajo që çon peshë është dëshmia e sigurtë dhe e qëndrueshme e Bajramit lidhur me faktin se paratë i janë dhënë policit për të zgjidhur çështjen e pronës. Kjo pjesë e dëshmisë është e patundur dhe pa të meta.

Në mënyrë që të shpjegohet se përse nuk ka qenë e mundur të gjurmohen paratë, mund të jepen shumë shpjegime alternative sipas së cilave nuk rezulton se dëshmia është e rrejshme: për shembull nuk mund të përjashtohet mundësia se dëshmitarit nuk i është kujtuar saktësisht mënyra e transferimit të parave dhe se paratë nuk janë dërguar përmes Western Union apo transferit, por i janë dhënë bashkëshortes së të pandehurit drejtpërdrejtë në dorë apo në ndonjë mënyrë tjetër që pamundëson gjurmimin përmes shpalosjes së të dhënave financiare.

Për më tepër, shpjegimet e dhëna nga i pandehuri me qëllim që të arsyetojë se përse vëllezërit Zeqiri do ta akuzonin rrejshëm atë janë, prapë, të dobëta. Në mënyrë që të zhvlerësojë deklaratat e mësipërme i pandehuri prapë foli për një komplot të kurdisur kundër tij.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Kësaj here komploti kundër tij do të ishte kurdisur sepse Nexhip Zeqiri ishte arrestuar në territorin e stacionit policor të Obiliqit dhe, me rastin e arrestimit të dytë, fjalë hakmarrjeje do të jenë thënë kundër tij nga Bajram Zeqiri.

Vetë i pandehuri ka pranuar se ai kurrë nuk e kishte arrestuar personalisht Nexhipin apo kishte zhvilluar hetime kundër tij dhe se në të dyja rastet arrestimet ishin thjesht zbatim i vendimeve gjyqësore.

Nën këto rrethana, është vështirë të besohet se Bajram Zeqiri ka vendosur të akuzojë në mënyrë të rrejshme komandantin e stacionit policor vetëm për shkak se ai ka zbatuar dy urdhra për arrestim të lëshuar nga autoritete të tjera gjyqësore, duke pranuar gjithashtu rrezikun e inkriminimit të vetvetes për kryerje të krimit.

Prandaj, është përfundim i Trupit gjykues se në fakt së paku pesëqind euro i janë dhënë të pandehurit nga Bajram Zeqiri, në mënyrë që komandanti t'i ndihmojë të lirohet prona e blerë nga Bajrami.

* * *

Sa i përket cilësimit ligjor, duket e qartë se sjellja e të pandehurit duhet të cilësohet si Marrje e Ryshfetit në kundërshtim me nenin 343, par. 1 i KPK.

Në fakt, përshkrimi i mësipërm dhe vlerësimi i provave ka demonstruar se i pandehuri ka marrë para për të kryer, brenda fushëveprimit të autoritetit të tij, një veprim zyrtar të cilin ai nuk është dashur ta kryejë.

Vlen të theksohet se koncepti i “veprim zyrtar apo veprim tjetër brenda fushëveprimit të autoritetit” do të thotë çdo ushtrim konkret i pushtetit lidhur me pozitat zyrtare dhe, prandaj, gjithashtu edhe sjelljet siç është intervenimi material i komandantit të stacionit policor me qëllim që të bindet personi që e ka uzurpuar pronën ta lirojë atë.

Gjithashtu është e qartë se prona është çështje që rregullohet përmes ligjeve civile dhe kërkon intervenimin e një akti gjyqësor për të vendosur se kush ka të drejtë të banojë në të. Prandaj, intervenimi i një polici në këtë çështje është diçka që, pos nëse është i lidhur me zbatim të një urdhri gjyqësor, nuk duhet të ndodhë.

Prandaj, është e qartë se, sa i përket ngjarjes aktuale, të dyja, edhe *actus reus* dhe *mens rea* e të pandehurit, janë dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

Sa i përket ngjarjes aktuale, edhe pozicioni i Bajram Zeqirit duhet të vlerësohet nga Prokuroria, meqë nga dëshmia e tij duket se ai ka kryer veprën penale të Dhënies së Ryshfetit, në kundërshtim me nenin 344 të KPK.

2.6. Ngjarja që përfshin Sedat Kelmendin (pika 6 e aktakuzës).

Sa i përket kësaj ngjarjeje, Prokurori, në seancën dëgjimore të 5 prillit 2011 ka tërhequr akuzën. Prandaj, sipas nenit 389, pika 1 e KPPK, akuza duhet të refuzohet.

Sidoqoftë, pozicioni i dëshmitarit Sedat Kelmendi meriton vëmendje.

Në fakt, ai ka përmendur se Bujar Grajqevci i ka dhënë atij pesëdhjetë Euro jo si kthim i pjesërishëm i parave për bombolën e gazit që i është dhënë policit nga Kelmendi në

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

shkëmbim të favorit që do të behej për ata dy, por për shkak se Kelmendi kishte humbur mobilin e tij në makinën e Grajqevcit.

Kjo pjesë e dëshmisë është qartazi e rrejshme dhe e pambështetur dhe, prandaj, dëshmitari duhet të denoncohet në Prokurori, meqë ai ka kryer veprën penale Deklarim i Rrejshëm, në kundërshtim me nenin 307 të KPK.

2.7. Ngjarja që përfshin Bekim Bajramin (pika 7 e aktakuzës).

Sa i përket kësaj ngjarjeje, e vetmja provë e paraqitur nga Prokurori ka qenë dëshmia e dhënë nga Bekim Bajrami.

Më poshtë paraqiten pjesët më relevante nga dëshmia e tij:

Bekim Bajrami: Takova komandantin e stacionit të policisë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sejdi Zeqirin?

Bekim Bajrami: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dhe çfarë ndodhi?

Bekim Bajrami: Ai më informoi se tashmë vendimi ishte marrë se nuk mund të posedoja leje të tillë për armë dhe prandaj unë duhet ti sjellja armët në stacionin e policisë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ishte kjo për të gjitha armët apo vetëm për njërën?

Bekim Bajrami: Të gjithat.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dhe pastaj?

Bekim Bajrami: Unë nuk doja ti sillja armët në stacionin e policisë. Nuk e shihja të arsyeshme apo të gjykoja se më duhej ti sillja armët, sepse i kisha hobi. Policët erdhën tek unë dy, tri, apo katër herë por unë nuk ia dhashë armët policisë. Nuk i vodha ato; i bleva ato me paratë e mia.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pastaj, keni pasur ndonjë takim tjetër me Sejdi Zeqirin?

Bekim Bajrami: Jo, privatisht jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në lidhje me këto armë?

Bekim Bajrami: Jo.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Në polici, me datë 29 gusht 2009 ju thatë se kishte pasur takim tjetër me Sejdi Zeqirin në lidhje me këto armë. A iu kujtohet tani ky takimi tjetër?

Bekim Bajrami: Dëgjo, nuk më kujtohen të gjithat, jo 100%. Nuk më kujtohet.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne jemi këtu që të iu freskojmë memorien tuaj; policisë ju i thatë se pas këtij takimi të parë në stacionin e policisë ju thatë se takuat Sejdi Zeqirin tri ditë më vonë në kafën e Ekremi në Obiliq. A po iu kujtohet tani që po iu stimuloj memorien tuaj?

Bekim Bajrami: Në këtë kafën e Ekremi unë shkoj për të pirë kafe, mbase ai ka qenë aty por unë nuk e kam takuar atë. E di kafën e Ekremi sepse shkoj aty shpesh.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju nuk shkëmbyet asnjë fjalë me të?

Bekim Bajrami: Jo, unë kurrë më nuk kam folur me të.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju i keni thënë policisë ndryshe, ju thatë se ju e takuat atë dhe ai iu tha se mund të bënte punën në lidhje me armët por ai duhet të jepte para për njerëzit sipër. Ju e pyetët atë se sa para duhej, dhe përgjigja e të pandehurit ishte 1000 Euro. Si është e mundur të jetë kjo deklaratë në dëshminë tuaj dhënë policisë?

...

Kryetari i trupit gjykses: Në deklaratë është e shkruar se i ke thënë Burim Thaqit se nuk do të i dorëzosh armët sepse Sejdi Zeqiri të ka kërkuar 1000 euro për njërën nga armët. A qëndron pas kësaj deklarate, po, apo jo?

Bekim Bajrami: Ndoshta është e mundur se kam thënë kjo është mënyra që është shkruar në deklaratë.

Kryetari i trupit gjykses: Është e mundur?

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Bekim Bajrami: Po, ndoshta kam thënë sepse isha shumë nervoz.

Kryetari i trupit gjykues: A ishte kjo e vërtetë, apo jo?

Bekim Bajrami: Jo, nuk ishte e vërtetë.

Kryetari i trupit gjykues: Dhe pasi që ishe nervoz ti e akuzove zyrtarin e policisë se të ka kërkuar të holla? Është deklarata e rëndë kundër një zyrtari të policisë³⁰.

Nga fragmentet e mësipërme të procesverbalit rezulton se, pasi kërkesa e bërë nga Bajrami për një autorizim për të mbajtur dy armë gjuetie është refuzuar, dëshmitari ka qenë në kontakt me të pandehurin duke u munduar të rregullojë gjërat.

Ekziston një mospërputhje e qartë në mes të asaj çfarë është thënë nga dëshmitari gjatë fazes së hetimeve, kur Bajrami ka deklaruar se komandanti ka kërkuar 1000 Euro në mënyrë që t'i ndihmojë atij lidhur me çështjen e armëve, dhe asaj që është thënë nga dëshmitari gjatë shqyrtimit kryesor kur Bajrami ka mohuar se komandanti kishte kërkuar një gjë të tillë.

Shpjegimi i dhënë nga dëshmitari për mospërputhjen është se, kur ai është marrë në pyetje nga policia ai ka qenë i shqetësuar prandaj ka dhënë një verzion të pavërtetë të fakteve.

Pavarësisht që ky shpjegim duket të jetë dobët dhe jo i besueshëm, Trupi gjykues ka vendosur që mbështetja vetëm në atë që është thënë nga dëshmitari gjatë fazës së hetimeve nuk është e mjaftueshme që të arrihet deri te konkludimi, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se i dyshuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet.

Kjo pjesë e dëshmisë është qartësisht e rrejshme dhe e pambështetur dhe, prandaj, dëshmitari duhet të denoncohet në Prokurori, meqë ka kryer veprën penale Deklarim i Rrejshëm, në kundërshtim me nenin 307 të KPK.

* * *

Nuk ka nevojë të bëhen vërejtje lidhur me cilësimin ligjor të bërë nga Prokurori.

2.8. Ngjarja që përfshin Nysret Smakollin (pika 8 e aktakuzës).

Sa i përket kësaj ngjarjeje, Prokurori, në seancën dëgjimore të 5 prillit 2011 ka tërhequr akuzën. Prandaj, sipas nenit 389, pika 1 e KPPK, akuza duhet të refuzohet.

2.9. Ngjarja që përfshin K H (pika 9 e aktakuzës).

Sa i përket kësaj ngjarjeje, prova e vetme e paraqitur nga Prokurori është dëshmia e dhënë nga pala e dëmtuar.

Më poshtë paraqiten pjesët më relevante nga dëshmia e saj:

K H: OK. Mund të vazhdojmë. Pas një kohe u paraqitën disa çështje lidhur me menaxhimin. Ajo ishte se stili i tij i menaxhimit ishte i ndryshëm nga ajo që kam konsideruar, dhe ka pasur disa probleme në këtë drejtim. Disa mosmarrëveshje të vogla filluan të cilat unë gjithmonë i injorova sepse nuk desha që gjërat të shtoheshin, dhe kam besuar se gjërat do të shkojnë prap në

³⁰ Procesverbali i 3 dhjetorit 2010, faqe 5-6 dhe 15.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

normalen. Në prani të kolegëve të mi, unë kam qenë e akuzuar në lidhje me faktin se nuk di se si të menaxhojë ndërrimin, për të cilën unë nuk kisha asnjë çështje në lidhje me te sepse kam respektuar hierarkisë dhe pasi ai ishte me grade më të lartë se unë, unë respektova strukturën dhe ende vazhdova ta respektoj hierarkinë. Çfarë më shqetësonte mua ishte fakti se Komandanti i stacionit i ngriti këto çështje për vëmendjen time përpara kolegëve të tjerë. Kam menduar se kjo nuk ishte e rregullt ose e drejtë.

Prokurori Publik Vendor: Ishte kjo e vetmja gjë, apo ishte aty diçka tjetër?

K H: Më tej, edhe pse kam kërkuar gjërat që të kthehen në normalitet, disa fjalë ofenduese u përmendën. Unë kam turp ti përmendi ato, por e bëra betimin dhe do ta bëjë këtë, nëse është e nevojshme.

Prokurori Publik Vendor: Cilat ishin këto fjalë?

K H: Ato ishin që unë do tu shesë për 50 cent, nuk e kam asnjë vlerë, që nuk e di se si të menaxhojnë, se pamja ime ishte e piset, dukem e piset, që nuk kishte asnjë vlerat, nuk di se si të eci. Kjo sjellje nuk ka ndodhur vetëm një herë. Kjo ka ndodhur disa herë. Megjithatë, unë do të doja të përmend, në lidhje me vërejtjen e parë që unë do tu shesë për 50 cent, ajo është përmendur vetëm një herë.

Prokurori Publik Vendor: A ju kujtohet kjo kur ka ndodhur?

K H: Më vjen keq, por nuk e mbaj mend datën dhe kohën. Unë kam qenë në zyrën e tij.

Prokurori Publik Vendor: Viti?

K H: Mund të jetë 2008³¹.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Po në lidhje me fjalë të tjera 'Ju nuk jeni me vlerë, ju nuk e dini se si të ecni, ju jeni një gjë e pistë' Kur ishin këto fjalë të përmendura?

K H: Këto fjalë u përmendën një vit pasi kam filluar punë në Stacionin e Policisë, nga 2006 e me tutje.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në sa raste?

K H: Pothuajse çdo ditë. Sa herë që kam qenë në ndërrim³².

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Dua të sqaroj këtë episod nga fjalët; "Ju nuk vleni 50 cent". A ka pas ndonjë reagim nga ju pasi keni dëgjuar këto fjalë?

K H: Po. Kam reaguar shumë ashpër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë thatë?

K H: Kam qenë shumë emocionuar në atë kohë, shumë emocionale. Une e shpreha veten nëpërmjet marrëdhënieve, si dhe fjalëve.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë keni thënë?

K H: Nuk e mbaj në mend. E di se unë bertita. Shkova te dera. I bertita përsëri. Isha e furishme.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në deklaratën e datës 01-12-2009, ju thate se pasi që keni dëgjuar këto fjalë, ju i thate: "Zotëri, a e dini se çfarë janë duke thënë". A është e vërtetë kjo? A ju kujtohet kjo?

K H: Kjo është shumë e mundur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pastaj thate se ju keni filluar të largoheni nga vendi, dhe ai e përsëriti të njëjtën gjë, ju that se ai ishte; "duke u thënë se unë nuk di te eci dhe më kërcënoi se ai do të kishte bërë më keq". A ju kujtohet?

K H: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Një episod tjetër pas kësaj. Keni dëgjuar këto fjalë dhe pas kësaj, çfarë keni bërë? Pas përgjigjes tuaj, a dolët nga zyra apo qëndruat në zyrë?

³¹ Procesverbali i 21 tetorit 2010, faqe 20.

³² Procesverbali i 21 tetorit 2010, faqe 21

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

K H: Unë u largova nga zyra. Isha duke shkuar në një mbledhje.

Kryetari i Trupit Gjykses: Cila ishte gjendja juaj? A ishit duke qarë? A ishit e mërzhitur?

K H: Unë isha e mërzhitur shumë. Kam qarë, dhe kam qenë duke shkuar poshtë shkallëve duke bërë titur dhe ulëritur³³.

Nga fragmentet e mësipërme të procesverbalit, duket se nga 2006 deri 2009 ka pasur disa raste të keqtrajtimit nga ana e të pandehurit kundër K H e cila shpeshherë është poshtëruar, fyer dhe përqeshur nga komandanti i saj.

Dëshmitarja qartë dhe pa ngurrime ka theksuar se cila ka qenë sjellja e komandantit dhe si është ndier ajo (mbi këtë pikë shih faqen 26 të procesverbalit të 21 tetorit 2010).

Nga aspekti i besueshmërisë së dëshmisë së mesipërme, vlerësimet e bëra mbi dëshmitë e M P dhe V G t vlejné gjithashtu edhe në rastin e K H dhe, prandaj, do të theksohen vetëm dallimet.

Para së gjithash, në konfirmim të besueshmërisë së dëshmitarit dhe mungesës së çdo qëllimi të saj për hakmarrje, vlen të përmendet se pala e dëmtuar, përpara dhënies së dëshmisë, ka pyetur nëse është e mundur të tërheqë akuzimet e saj kundër komandantit. Më poshtë paraqitet pjesa përkatëse e procesverbalit:

K H: Nëse më lejohet, do të doja të shtoja diçka para se te përgjigjem, në konfirmimin e aktakuzës unë u tërhoqa nga të gjitha keto. Sot unë kam qenë e thirrur si dëshmitar. U betova se do të them të vërtetën, por nuk e kuptoj, duke qenë se jam tërhequr, ku do të shkojmë kështu?

Kryetari i Trupit Gjykses: Këto krime të ndiqen sipas detyrës zyrtare. Ajo është e parëndësishme që ju e tërhoqët akuzat tuaja. A e keni kuptuar?

K H tregon se ajo kupton.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju jeni të detyruar tani të thoni të vërtetën, pa marrë parasysh nëse doni që i pandehuri të ndiqet penalisht apo jo. Kjo nuk është në duart tuaja më. Ju duhet vetëm të thoni se çfarë ka ndodhur, dhe të thoni të vërtetën. Kjo është detyra juaj tani³⁴.

Vlerësimet tashmë të bëra lidhur me dobësinë e dëshmive të paraqitura nga mbrojtja me qëllim që të zvogëlohet besueshmëria e M P dhe V G t vlejné gjithashtu edhe për K H, por duhet të theksohen disa dallime.

Lidhur me arsyet e Ks për të akuzuar rrejshëm të pandehurin, Zeqiri ka dhënë shpjegimet si në vijim:

Kryetari i Trupit gjykses: Cila ishte arsyeja që u ka denoncuar rrejshëm?

Sejdi Zeqiri: Sa e di unë, e kam parë deklaratën e saj dhe ajo flet mirë për mua, më shumë se që më denoncon në fakt.

Kryetari i Trupit gjykses: Ajo ka thënë se e keni fyer në shumë raste. Nëse keni shpjegim, por ndoshta nuk keni shpjegim.

Sejdi Zeqiri: Gjithmonë e kam motivuar dhe këshilluar.

Kryetari i Trupit gjykses: Nuk keni shpjegim për këto pretendime të rrejshme?

Sejdi Zeqiri: E keni fjalën për Kn?

Kryetari i Trupit gjykses: K H.

Sejdi Zeqiri: Pas arrestimit tim, ajo është thirrur dhe është kerkuar nga ajo që të përgatisë një denoncim kundër Komandantit.

³³ Procesverbali i 21 tetorit 2010, faqe 24-25.

³⁴ Procesverbali i 21 tetorit 2010, faqe 19-20.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Kryetari i Trupit gjykues: Nga kush?

Sejdi Zeqiri: M P.

Kryetari i Trupit gjykues: Nga e dini këtë?

Sejdi Zeqiri: E thashë më herët se policët ishin me të kur është thirrur ,kur ka qenë në shtëpi, për të përgatitur deklaratën e saj.

Kryetari i Trupit gjykues: Përsëriteni ju lutem, nga e dini këtë?

Sejdi Zeqiri: Ajo ka thënë, 'Unë kurrë nuk jam ankuar lidhur me Komandantin.'

Kryetari i Trupit gjykues: Nga e dini këtë? Jeni duke cituar fjali të thëna nga persona të tjerë duke mos qenë aty. Nga e dini këtë?

Sejdi Zeqiri: Kjo ka ndodhur.

Kryetari i Trupit gjykues: Po, por ju jeni polic, në shqyrtim kryesor nuk mund të thoni 'kjo ka ndodhur'. Ju mund të thoni, por kjo nuk çon peshë.

Sejdi Zeqiri: Ua kam thënë herën e kaluar, më është thënë nga një rreshter në stacion policor, Ahmet Jusufi.

Kryetari i Trupit gjykues: K H ka qenë me gradë më të lart në raport me M P?

Sejdi Zeqiri: Po.

Kryetari i Trupit gjykues: Atëherë, si i është binduar ajo udhëzimeve të dhëna nga një police me gradë më të ultë se ajo?

Sejdi Zeqiri: Nuk e di³⁵.

Prapë, arsyeja e dhënë nga komandanti (K është udhëzuar nga M ta denoncojë atë rrejshëm) duket plotësisht e pabazuar dhe e pambështetur. Prapë është e vështirë të besohet se një polic mund të pranojë të akuzojë rrejshëm komandantin e saj vetëm për shkak se është nxitur nga një koleg. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit kryesor nuk është shfaqur asgjë që mund të çojë deri te konkludimi se në mes të dy femrave ka ekzistuar një shoqëri e fortë apo lidhje e ngushtë.

Në anën tjetër, sjellja e komandantit e përmendur nga K përputhet në mënyrë të përkryer me përshkrimin e dhënë nga femrat e tjera viktime lidhur me sjelljen tiranizuese të të pandehurit.

Prapë, fjalët e përdorura nga K H (ai është sjellur si “mbret” dhe “diktator”) janë shumë të rëndësishme për të kuptuar se cila ishte atmosfera në stacionin policor në Obiliq.

Prandaj, mendimi i Trupi gjykues është se në fakt i pandehuri nga 2006 deri 2009 ka keqtrajtuar viktimën K H duke e fyer, poshtëruar dhe kërcënuar.

* * *

Sa i përket cilësimit ligjor, duket se sjellja e të pandehurit duhet të klasifikohet si Keqtrajtim gjatë Ushtrimit të Detyrave, në kundërshtim me nenin 164, par. 1 të KPK.

Në fakt, përshkrimi i mësipërm dhe vlerësimi i provave demonstroi se viktime është fyer dhe keqtrajtuar në disa raste nga i pandehuri derisa ai ka ushtruar detyrat e tij.

Prandaj, është e qartë se sa i përket kësaj ngjarjeje, të dyja, edhe *actus reus* dhe *mens rea* janë dëshmuar përtej dyshimit të bazuar.

Vlen të theksohet se Prokurori kishte klasifikuar sjelljen e të pandehurit si Shpërdorim të Detyrës Zyrtare apo Autorizimit në kundërshtim me nenin 339, par. 1 të KPK.

³⁵ Procesverbali i 5 prillit 2011, faqe 14-15.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Klasifikimi i mësipërm është qartazi i gabuar, meqë vepra penale Shpërdorim i Detyrës Zyrtare apo Autorizimit përfshin përfitimin material apo dëmin material gjë që sigurisht se nuk është i pranishëm në këtë rast.

Në këtë pikë, nëse është e pakontestueshme se cilësimi i dhënë nga Prokurori nuk është detyrues për gjykatësin, siç është e paraparë qartë në nenin 386 të KPPK, në anën tjetër kodi nuk specifikon nëse gjykatësi mund të riklasifikojë akuzën nëse kjo do të ishte në dëm të të akuzuarit (siç ka ndodhur në rastin aktual, meqë neni 339, par. 1 i KPK parasheh ndëshkim më të rëndë se neni 164, par. 1 i KPK).

Prandaj, në pajtim me parimin shpjegues *ubi lex voluit, dixit, ubi noluit, tacuit* (kur ligji ka dashur të rregullojë një çështje e ka bërë këtë, kur nuk ka dashur nuk e ka bërë-*përkthim i lirë-shënim i përkthyesit*), duhet të supozohet se gjykatësi është i lirë të riklasifikojë veprat penale pa marrë parasysh faktin se kjo shkon në dëm të të pandehurit.

Megjithatë, gjykatësi duhet të ketë parasysh gjithashtu edhe parimin e paraparë me KEDNj, konventë e cila, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, është e aplikueshme drejtpërdrejtë në territorin e Kosovës dhe, në rast të konfliktit, ka prioritet ndaj ligjeve të tjera.

Në veçanti, sa i përket mundësisë që gjykatësi të riklasifikojë akuzën, dispozitat e nenit 6, par. 3 pikat a dhe b të KEDNj duhet të merren parasysh. Dispozitat e mësipërme theksojnë se i pandehuri ka të drejtë të informohet për akuzat ndaj tij dhe duhet të ketë kohë adekuate për të përgatitur mbrojtjen e tij.

Në këtë pikë, jurisprudenca e KEDNj (*Drassich vs Italy*, 11.12.2007) ka treguar se nëse gjykatësi ka pushtetin të riklasifikojë akuzat (dhe duhet të vërehet se në rastin e mësipërm ka qenë riklasifikim *in peius*), të pandehurit duhet t'i jepet e drejta për t'u informuar mbi mundësinë e cilësimit ndryshe të akuzës, duke i dhënë gjithashtu mundësinë të pandehurit të paraqesë argumentet dhe mbrojtjen e tij lidhur me cilësimin e ri eventual.

Kjo është ajo që saktësisht ka ndodhur në këtë rast. Trupi gjykues paraprakisht ka informuar të pandehurin lidhur me këtë mundësi³⁶ dhe prandaj, pavarësisht nga reagimi i ashpër i avokatit mbrojtës, i cili u tregua i pavetëdijshëm mbi jurisprudencën bazike të KEDNj, ka plotësuar të gjitha obligimet e tij kundrejt të pandehurit.

2.10. Ngjarja që përfshin K Bn (pika 10 e aktakuzës).

Sa i përket kesaj ngjarjeje, prova e vetme e paraqitur nga Prokurori është dëshmia e dhënë nga pala e dëmtuar.

Më poshtë paraqiten pjesët më relevante nga dëshmia e saj:

K B: Më 9 gusht. Në atë kohë isha në punë. Në oborr të shtëpisë sime u sulmuan fëmijët e mi. Kur më thirrën fëmijët dhe më informuan për këtë ngjarje, isha e afektuar thellë dhe është e vështirë të

³⁶ Procesverbali i 1 prillit 2011, faqe 32.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

shpjegoj si jam ndier në atë moment. Fëmiju im 12 vjeçar ishte goditur. Më kishin informuar se fëmiju kishte vdekur. Kam nxituar në shtëpi nga puna, kur kam shkuar atje makinat e policisë kishin arritur, ata kishin arritur më shpejtë dhe fëmijët e mi ishin dërguar në Emergjencë. Kam shkuar me një polic në Stacion Policor, dhe edhe një herë kërkova të takoj komandantin, Sejdi Zeqirin. Ai nuk më ka pranuar në ditën kritike. Kur nuk më pranoi atë ditë, atëherë kam ardhur në Prishtinë te zyreja e Prokurorit dhe ia kam shpjeguar rastin. Ia kam shpjeguar ngjarjen dhe jam kthyer në shtëpi.

...
Ai (Prokurori) vetëm më morri emrin dhe mbiemrin. Në fakt, atë ditë unë vetëm kam adresuar rastin, ai nuk më ka marrë emrin dhe mbiemrin. Të nesërmen kam qenë në punë kur Sejdi Zeqiri më ka telefonuar në numrin fiks. Më ka pyetur nëse jam K B, unë thashë, "Po." Ai vazhdoi dhe tha, "A mund të vish në zyren time meqë dua të bisedoj me ju." Kur shkova në zyren e tij, menjëherë pas telefonatës, ai ishte duke pritur aty dhe në këmbë, duke ecur rrotull. Dera e zyrës ishte e hapur. Posa më pa tha, "Kush je ti, në vend se të vish te unë dhe shkon më lart për të folur?" Unë u përgjigja, "Pasi asnjëherë nuk m'i ke zgjidhur problemet apo ndihmuar, pasi ka instanca të tjera ku dikush mund të adresojë çështjet e tilla, vendosa të shkoj." Ai tha, "A di ti se derisa të jem unë këtu ti nuk guxon të shkosh diku tjetër? Shihet se nuk je normal." Ai filloi të më ofendojë. Ai gjithashtu tha, "A e di ti se unë mund të të paraburgos?" Unë thashë, "Urdhëro, më paraburgos. Ndoshta dikush do të vijë dhe do të më rrahë në qeli."

Kryetari i Trupit gjykses: Cilat fjalë u thanë nga togeri?

K B: "Ti nuk je normal. Nuk të vjen turp që bën gjëra të tilla. Do të ishte më mirë nëse kujdesesh për fëmijët e tu dhe të shikosh punën tënde." Dhe në fund ai tha, nëse nuk gaboj, "Shko ku të duash. Nuk m'ërzitem për askënd. Vetëm unë jam këtu. Askush nuk është më lart se unë."

Kryetari i Trupit gjykses: A e ka përmendur ndonjëherë fjalinë, "Ti je grua e marrë."?

K B: E ka përmendur gjatë kohës që ka qenë i tërbuar, ka përmendur çdo lloj fjalësh. "Ti nuk je normal" apo "Je e marrë" është e njëjta gjë.

Kryetari i Trupit gjykses: A i ka thënë fjalët "Ti je grua e marrë" apo jo?

K B: Po, ka thënë "Ti je e marrë, jo normal."

Kryetari i Trupit gjykses: A ka thënë gjithashtu, "Ti je idiote"? Nëse të kujtohet.

K B: Kjo nuk më kujtohet, por e di se shumë fjalë ofenduese janë përmendur në atë kohë.

Prokurori Publik vendor: A ju kujtohet data kur ka ndodhur kjo?

K B: Episodi problematik ka ndodhur më 9 gusht. Ka qenë ditëlindja e vajzës sime, por nuk më kujtohet data kur kam shkuar në zyren e tij.

...

Kryetari i Trupit gjykses: Në deklaratë shkruan 29 gusht, por ju thatë se keni pasur një zënkë me fqinjët më 9 gusht

...

Sa kohë pas këtij incidentit të parë jeni thirrur nga Sejdi Zeqiri dhe është kërkuar nga ju teshkoni në Stacionin Policor?

K B: Nuk e di saktësisht, sepse isha duke përcjellur gjendjen e djalit tim në njësinë e emergjencës.

Kryetari i Trupit gjykses: A është e mundur që ka qenë pak a shumë 10 më vonë?

K B: 7 apo 8. Diku në mes të një jave dhe 10 ditësh³⁷.

Nga fragmentet e mesipërme të procesverbalit, duket se në gusht 2009 ka ndodhur një ngjarje e pamohueshme keqtrajtimi kundër viktimës. K B është poshtëruar, kërcënuar dhe fyer nga i pandehuri. Dëshmitarja ka theksuar qartë dhe pa ngurruar se cila ka qenë sjellja e komandantit dhe si është ndier ajo.

³⁷ Procesverbali i 20tetorit 2010, faqe 32-34.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Sa i përket besueshmërisë së dëshmisë së mësipërme, vlerësimet e bëra lidhur me dëshmitë e M P, V Gt dhe K H vlejné gjithashtu për K Bn dhe prandaj do të theksohen vetëm dallimet.

I pandehuri ka pohuar se akuzat kundër tij të bëra nga viktimat janë trillime dhe të pavërteta. Në veçanti, ai ka pretenduar se ka qenë M P ajo që ka shtyrë K Bn të ngrejë akuza të falsifikuara kundër tij (akuza të falsifikuara të lidhura jo vetëm me këtë rast, por edhe me një rast dhunimi në të cilin i pandehuri do të ketë luajtur rolin e shtytësit³⁸).

Meqë ky rasti i fundit nuk ka qenë lëndë e aktakuzës aktuale, Trupi gjykues ka vendosur që mos të hetojë më tutje dhe nuk u ka lejuar palëve të eksplorojnë çështjen.

Megjithatë, teoria e komplotit e pretenduar me kryeneçësi nga mbrojtja duket të jetë e dobët në krahasim me dëshminë solide dhe të sigurtë të dëshmitares.

Rrethana se ka pasur një komplot kundër komandantit dhe se M P ka arritur të bind K Bn që në mënyrë të rrejshme të akuzojë komandantin e stacionit policor në Obiliq (një person me pushtet të pakontestueshëm në komunë) duket e paqëndrueshme. Edhe një herë, pretendimet e të pandehurit nuk mund të përmbysin qëndrueshmërinë e dëshmisë së viktimës e cila pa asnjë kundërtënie dhe pa asnjë arsye të qëndrueshme për hakmarrje qartazi ka akuzuar komandantin për keqtrajtimit ndaj saj.

* * *

Sa i përket cilësimit ligjor, duket qartë se sjellja e të pandehurit duhet të klasifikohet si Keqtrajtimit gjatë Ushtrimit të Detyrave në kundërshtim me nenin 164, par. 1 i KPK.

Në fakt, përshkrimi i mësipërm dhe vlerësimi i provave ka demonstruar se viktimat është fyer, frikësuar dhe keqtrajtuar nga i pandehuri derisa ai ka ushtruar detyrat e tij.

Prandaj, është e qartë se sa i përket kësaj ngjarjeje, të dyja, edhe *actus reus* dhe *mens rea*, janë dëshmuar përtej dyshimit të bazuar.

* * *

Vërejtje të përgjithshme mbi praninë e palëve të dëmtuara/dëshmitarëve gjatë prezantimit të dëshmive.

Vlen të përmendet se avokati mbrojtës Z. Tmava, në fjalën e tij përfundimtare, ka vërejtur se mënyra e dëshmimit të dëshmitarëve është zhvilluar në kundërshtim të nenit 164, par. 1 i KPPK, meqë palët e dëmtuara të cilët nuk kishin dëshmuar ende kanë qenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje.

Deklarata e mësipërme është e gabuar nga pikëpamja ligjore dhe e pavërtetë nga pikëpamja faktike.

Është e njohur se neni 361, par. 1 i KPPK thotë se “Në parim, dëshmitari i cili ende nuk është marrë në pyetje, nuk është i pranishëm gjatë shqyrtimit të provave”.

Pjesa e vënë e fjalisë ‘në parim’ e bën të qartë se kjo dispozitë nuk është mandatore dhe se mund të shmangemi nga ajo varësisht nga rrethanat.

³⁸ Procesverbal i 1 prillit 2011, faqe 24-26.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Neni 361 i KPPK është *lex specialis* në kuptim të nenit 164, par. 1 i KPPK (që thotë se dëshmitari duhet të merret në pyetje jo në prani të dëshmitarëve të tjerë), meqë është një dispozitë që ka të bëjë me shqyrtimin kryesor, ndërsa kjo e fundit ka të bëjë me dëshmitë në përgjithësi.

Për më tepër, nëse dëshmitari i cili është i pranishëm gjatë shqyrtimit të provave është gjithashtu edhe palë e dëmtuar, një dispozitë tjetër duhet të merret parasysh: në fakt neni 80, par. 3 i KPPK specifikon se pala e dëmtuar ka të drejtë t'i shtrojë pyetje dëshmitarit dhe të bëjë vërejtje lidhur me dëshminë e tyre.

Prandaj është e qartë se gjatë shqyrtimit të provave (për shembull gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit) pala e dëmtuar, edhe pse ai/ajo është gjithashtu dëshmitar, ka të drejtë të jetë i/e pranishëm/e, përndryshe të drejtat e tij/saj të parapara në nenin 80 të KPPK do të mohoheshin në mënyrë të kundërligjshme.

Formulimi i dy dispozitave si duket kundërthënëse (neni 80 dhe neni 361) e bën të qartë se kjo e para mbizotëron.

Për më shumë, deklarata e avokatit është gjithashtu e pavërtetë nga pikëpamja faktike. Nga procesverbali i 18.10.2010 (faqe 11) rezulton se palët e dëmtuara, edhe pse janë informuar për të drejtën e tyre të jenë të pranishme, e kanë vendosur të lëshojnë gjykatoren gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të tjerë dhe palëve të tjera të dëmtuara.

3. PËRCAKTIMI I NDËSHKIMIT

Kur përcakton sanksionin penal, Trupi gjykues duhet të marrë parasysh edhe qëllimin e përgjithshëm të ndëshkimit – që është ndalimi i aktiviteteve të rrezikshme për shoqërinë duke parandaluar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale – edhe qëllimin specifik që është parandalimi i përsëritjes së veprës penale nga kryerësi i saj.

Në rastin aktual Trupi gjykues ka ardhur në përfundim se veprat penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor janë vepra penale të rënda, të kryera me qëllim nga komandanti i stacionit policor në Obiliq. Në anën tjetër, Trupi gjykues, sa i përket çështjes së llogaritjes së ndëshkimit kryesor për veprat e mësipërme penale, ka marrë parasysh se i pandehuri nuk ka dosje penale.

Për më shumë, sjellja e të pandehurit, i cili ka treguar një tendencë të qartë për të përfituar nga pozita e tij e pushtetshme brenda zyres në mënyrë që të kryejë veprat penale, ka shtyrë trupin gjykues që gjithashtu të shqiptojë ndëshkimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik në kohëzgjatje maksimale të paraparë me ligj.

Prandaj, ndëshkimi përcaktohet si në vijim:

- gjashtë muaj burgim për veprën penale Shpërdorim Seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin (pika 1) me ndëshkimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për 3 vite;

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

- katër muaj burgim për veprën penale Shpërdorim Seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin në Tentativë (pika 3) me ndëshkimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për 3 vite;
- një vit e gjashtë muaj burgim për veprën penale Marrje e Ryshfetit (pika 5) me ndëshkimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për 3 vite;
- gjashtë muaj burgim për veprën penale Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave, (pika 9) me ndëshkimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për 3 vite;
- katër muaj burgim për veprën penale Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave, (pika 10) me ndëshkimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për 3 vite.

Dënimi unik, në pajtim me nenin 71 paragrafi (1), (2) nën-paragrafi 3 dhe par. 3, i KPK, përcaktohet në 2 vite e katër muaj burgim me ndëshkimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për 3 vite.

Koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga i pandehuri prej 27.8.2009 deri më 5.1.2010 do të llogaritet në dënim, në pajtim me nenin 391 paragrafi (1), nën-paragrafi 5 dhe neni 278 par. 7 i KPPK.

4. SHPENZIMET

I akuzuari duhet të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Shpenzimet janë përcaktuar në 40 Euro për çdo seancë dëgjimore, pra, gjithsej 640 Euro.

5. KËRKESA PËR KOMPENSIM

Në fillim të shqyrtimit kryesor palëve të dëmtuara u është përkujtuar mundësia e parashtrimit të kërkesës për kompensim brenda procedurës penale, në pajtim me KPPK, neni 355, par. 2, por ata kanë deklaruar se nuk e kanë ndërmend të parashtrojnë kërkesë për kompensim.

Prandaj, Trupi gjykues nuk ka pasur nevojë të nxjerrë vendim të posaçëm mbi këtë çështje.

6. MJETI LIGJOR

Mjeti ligjor: në pajtim me nenin 400 të KPPK, ankesa duhet të paralajmërohet brenda 8 ditësh nga shpallja e këtij aktgjykimi.

VERZION I REDAKTUAR PËR PUBLIKIM

Në pajtim me nenin 407 të KPPK, ankesa duhet t'i parashtrohet Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, përmes Gjykatës Komunale në Prishtinë, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Procesmbajtës

Kryetari i Trupit gjykues

Natasa Malesevic

Gianfranco Gallo